

RAPORTI VJETOR I PUNËS

2020

Komuna e Gjakovës

Rr. UÇK
50,000 - Gjakovë



I.	Hyrje.....	3
II.	Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative.....	4
III.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa.....	8
IV.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.....	14
V.	Drejtoria për Shërbime Publike.....	16
VI.	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.....	30
VII.	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	36
VIII.	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....	39
IX.	Drejtoria për Punë Inspektuese.....	41
X.	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.....	44
XI.	Drejtoria për Arsim.....	49
XII.	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.....	57
XIII.	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.....	61

HYRJE

Ky raport pasqyron punën dymbëdhjetë mujore të ekzekutivit të Komunës së Gjakovës.

Edhe përkundër pengesave nga pandemia COVID 19, ne kemi arritur që të realizojmë planin e punës mbi 90% . Përgjatë këtij viti, edhe pse kemi punuar me staf të reduktuar, kemi arritur që të mbajmë standardin e një ndër komunave me menaxhimin më të mirë të buxhetit, realizimin e punëve kundrejt kërkesave të qytetarëve.

Performanca komunale është rritur dhe kjo shihet edhe në raportet e Auditorit të Përgjithshëm e edhe në sondazhet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare.

Projekte si Stadiumi i Qytetit, Hyrje – Daljet e qytetit, Qarkoret dhe shumë projekte tjera që fillimisht kishin mbështetjen e pushtetit qendror, me ardhjen e qeverisjes së re janë pezulluar si pasojë e tërheqjes së buxhetit për realizimin e tyre.

Por ne kemi premtuar dhe kemi qenë të obliguar që këto projekte t'i realizojmë me buxhetin vetanak dhe ndihmën e pakursyer të donatorëve.

Më tutje do të mund të gjeni detaje rreth realizimit të këtyre projekteve në veçanti dhe raportin e punës një vjeçare të ekzekutivit në tërësi.

Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative

Ky raport pasqyron punën e Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative në Komunën e Gjakovës për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2020. Në këtë raport janë përfshirë punët dhe aktivitetet e kryera nga Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative (DPPA).

Certifikata e lëshuara për vitin 2020	
Certifikatat e emëruara	Certifikata e lëshuara
Certifikata Familjare	3265
Certifikata të Martesës	3821
Certifikata të Lindjes	20.321
Certifikata të Vendbanimit	358
Certifikata të Nënshetësisë	138
Ekstrakt i Lindjes	44.494
Vërtetim Arkive	455
Certifikata e statusit Martesor	716
Lidhje martese	4293
Certifikata të Vdekjes	1090
Aktvendime	1553
Të tjera ofiqarie	5
Taksa të verifikimeve të dokumenteve të ndryshme	20

Sqarim: Raporti i E- kioskave aparat digjital –ATM shërbim 24h/7, gjatë vitit 2020-të nuk kanë qenë funksionale, pasi që kontrata me operatorin ekonomik ka përfunduar në fund të 2019-tës. Kjo kontratë ishte e planifikuar për vitin 2020, por nuk ka aplikuar asnjë operator ekonomik. I njëjti aktivitet i prokurimit është planifikuar edhe për vitin 2021.

E-kioska 1 te objekti i komunës (ish bankosit)	
Certifikatat e emëruara	Certifikata të lëshuara
Ekstrakt i Lindjes	246
Certifikatë e lindjes	103
Certifikatë e martesës	20
Certifikatë e nënshtetësisë	4
Certifikatë e vendbanimit	5
Certifikatë e vdekjes	0

E-kioska 2 te Posta kryesore	
Certifikatat e emëruara	Certifikata të lëshuara
Ekstrakt i lindjes	1
Certifikatë e lindjes	0
Certifikatë e martesës	0
Certifikatë e nënshtetësisë	0
Certifikatë e vendbanimit	0
Certifikatë e vdekjes	0


Sqarim: Zyra e pranimit dhe arkivës gjatë vitit 2020 ka pranuar gjithsej; 31,229 lëndë, prej të cilave 28,437 janë përfunduar dhe 2792 janë ende në proces.

Raport pune për lëndët e pranuar gjithsej: të miratuara, të refuzuara dhe në proces nga Zyra e Pranimit dhe Arkiva			
Drejtoria	Lëndët e pranuar	Të përfunduara	Në proces
Zyra e Kryetarit	2,514	1898	616
Asambleja Komunale	257	202	55
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative	20,535	19,742	793
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	382	307	75
Drejtoria për Arsim	546	486	60
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	602	547	55
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	161	95	66
Drejtoria për Urbanizëm e planifikim urban dhe rural	1,056	663	393
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	393	343	50
Drejtoria për Shërbime Publike	652	430	222
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	82	79	3
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	2,378	2,133	245
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	39	38	1
Drejtoria për Punë Inspektuese	1,559	1,401	158
Zyra Komunale për Komunitete	78	73	0

Raport për aktivitete e vitit 2020

- Gjatë kësaj periudhe është bërë furnizimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit (kontratë dy vjeçare)
- Realizimi i furnizimit me material për masat Anti COVID -19
- Mirëmbajtja e objektit komunal të komunës së Gjakovës
- Furnizimi me material elektrik dhe hidraulik
- Mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve
- Furnizim me Kompjuter dhe Laptop - Digjitalizimi i Administratës, kompjuter, printer, usb, etj.
- Mirëmbajtja e shtyllave Multifunkionale, Qyteti i mençur dhe Kamerat (Ky aktivitet ka pasur për qëllim mirëmbajtjen e rregullt të Kamerave dhe pajisjeve tjera Smart City që janë të instaluar në qytet si pjesë e fazës së I-rë. Gjithashtu janë ndërruar edhe disa pajisje të dëmtuara si kamera, switch etj që janë konstatuar se janë me defekte. Përgjithësisht kamerat publike janë aktive dhe në gjendje të mirë funksionale,
- Mirëmbajtja e Gjakova Portal dhe Mobile aplikacioni. Komuna e Gjakovës e ka zhvilluar dhe ka në përdorim Mobil Aplikacionin në platformën Android dhe iOS. Mobil Aplikacioni është i ndërlidhur me web faqen e komunës kk.rks.gov.net/gjakove dhe web portalin GjakovaPortal.com.
- Mirëmbajtja e aplikacionit e – shpenzimet (Si aplikacion me rëndësi të veçantë për Komunën e Gjakovës dhe si faktorë i konsiderueshëm për rritjen e transparencës në Komunën e Gjakovës përkatësisht buxhetit, borxheve dhe shpenzimeve të secilës drejtori. Aplikacionit e-Shpenzimet i janë përditësuar disa ndryshime, ashtu që të jetë në hap me teknologjinë e sotme dhe si rezultat të ketë përdorim më të lehtë, kuptueshmëri më të lehtë, shpejtësi dhe siguri më të madhe.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa



SEKTORI PËR BUXHET

Sektori për Buxhet, punën dhe aktivitetin e vet e ka bazuar dhe orientuar komfor objektivave të këtij sektori të parapara me plan-programin operativ dhe të mbështetur me aktivitetet përkatëse të ndërmarra gjatë vitit kalendarik.

Objektivat kryesore të Sektorit për Buxhet për vitin fiskal 2020:

- ❖ Procedimi i bartjes së të hyrave vetanake nga viti paraprak fiskal 2019 në vitin 2020.
- ❖ Përpilimi i Kornizës Afatmesme të shpenzimeve (KASH-it) dhe Qarkoreve buxhetore komunale në afat ligjor, sipas Rekomandimeve të MF-ve, dhe Qarkoreve buxhetore për Komuna.
- ❖ Hartimi i Rishikimit të Buxhetit komunal, eventualisht ri-alokimeve në afatin ligjor sipas Instruksioneve të MF-ve dhe Përpilimi i Buxhetit vjetor komfor Qarkoreve Buxhetore të lëshuara nga MEF-i.
- ❖ Procedimi i rezervës komunale në vlerën prej 2 milion eurosh të destinuar për ligjin e pagave i cili rezultoi i pavlefshëm.
- ❖ Organizimi i Dëgjimeve Buxhetore me Publikun për Buxhetin për të parën herë online, në pa mundësinë e organizimit fizik si rezultat i pandemisë COVID 19 dhe Përpilimi i Planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Cash-Flow) sipas Buxhetit fillestar të rishikuar dhe transfereve – ri destinimeve.

SEKTORI PËR TATIMIN NË PRONË

Objektivat kryesore të Sektorit për tatimin në pronë:

- Realizimi i planit të të hyrave buxhetore vjetore nga Tatimi në pronë në shkallën mbi planin e parashikuar.
- Lëshimi i faturave tatimore në afat për vitin përkatës.
- Anketimi i pronave të reja dhe ri anketimi dhe aplikimi i faljes së borxheve sipas ligjit.

SEKTORI PËR FINANCA

Objektivat kryesore të Sektorit për financa ishin si vijon:

- Përpilimi në afat i Pasqyrave Financiare vjetore për MF-ve.
- Përgatitja e Raportit vjetor Financiar me analizë mbi të hyrat dhe shpenzimet për vitin përkatës.
- Realizimi i Rekomandimeve të ZAP-it mbi të gjeturat për pasqyrat financiare të Komunës për vitin përkatës.
- Menaxhimi dhe ekzekutimi buxhetit vjetor komunal.
- Përgatitja e Informatave Financiare me analizë mbi të hyrat dhe shpenzimet mujore dhe periodike (I,II,III) vjetore për Asamblenë Komunale dhe MF-ve.

SEKTORI PËR TË HYRA KOMUNALE

Objektivat kryesore të Sektorit për të hyra janë si në vijim:

- Regjistrimi i të gjitha të hyrave komunale, për të gjitha programet buxhetore të Komunës dhe raportimi i tyre.
- Barazimet mujore të të hyrave komunale komfor dispozitave ligjore dhe Rregulloreve komunale në fuqi.
- Alokimi i të hyrave në pajtueshmëri me buxhetin komunal të miratuar.

KATEGORITË BUXHETORE KOMUNALE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP, të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Gjakovës. Komuna e Gjakovës kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e tija financohen nga Buxheti i Kosovës.

Komuna e Gjakovës nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Gjakovës janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme.

SHPENZIMET BUXHETORE KOMUNALE 2016 – 2020

Komuna e Gjakovës	2016 (Shpenzuar)	2017 (Shpenzuar)	2018 (Shpenzuar)	2019 (Shpenzuar)	2020 (Shpenzuar)
Paga dhe mëditje	11,838,180.07	11,713,514.51	13,252,490.92	13,599,827.88	14,243,405.32
Mallra dhe shërbime	1,138,464.17	1,233,560.17	2,234,274.89	2,802,467.14	3,689,748.96
Shpenzime komunale	465,292.76	430,052.96	549,083.33	579,693.17	532,669.54
Subvencione dhe transfere	449,971.85	397,650.80	459,572.71	482,643.78	683,270.70
Shpenzime kapitale	5,148,271.09	4,634,189.30	6,613,965.16	8,130,228.64	8,195,519.73
Totali :	19,040,179.94	18,408,967.74	23,109,387.01	25,594,860.61	27,344,614.25
Numri i stafit	2258	2232	2232	2238	2238

Trendet historike të financimit sipas strukturës ekonomike për Komunën e Gjakovës 2016 - 2020, për periudhën Janar - Dhjetor.

TË HYRAT BUXHETORE

Në tabelën e bashkangjitur janë të paraqitura të hyrat vetanake komunale sipas Drejtorive Komunale

BURIMET E TË ARDHURA VE	Realizimi 2015	Realizimi 2016	Realizimi 2017	Realizimi 2018	Realizimi 2019	Realizimi 2020
Urbanizmi	296,986.49	490,801.77	312,006.06	638,048.20	505,763.41	691,639.52
Shërbimet	9,229.70	13,342.30	30,761.19	76,467.83	36,050.00	25,886.00
Inspeksioni	56,977.92	52,272.00	60,574.06	91,980.40	109,649.59	84,078.95
Bujqësia	23,044.73	49,899.34	48,141.55	36,241.37	55,649.60	31,843.19
Kadastra	165,079.55	137,678.10	166,392.20	165,614.50	153,795.75	124,300.00
Zhvillimi	60,358.80	40,507.40	39,757.00	70,211.30	64,943.50	24,075.80
Administrata	139,777.50	132,567.50	131,371.00	133,880.57	131,652.05	85,464.08
Buxhet e Financa	1,344,212.06	1,747,534.10	1,631,239.50	1,645,401.30	1,899,760.18	1,628,025.96
Dënimet në Trafik	141,536.00	195,827.30	268,084.00	516,773.50	555,010.50	379,612.55
Të hyrat nga Gjykata	133,220.00	107,510.00	78,485.00	83,140.00	34,030.00	26,230.00
Arsimi	148,511.50	167,366.50	196,165.42	188,192.43	268,584.83	144,192.45
Kultura	11,131.00	12,025.00	13,685.00	12,922.50	14,129.00	8,370.00
Shëndetësia	51,143.50	57,220.50	54,368.00	62,744.00	88,432.10	11,511.80
TOTALI I TË HYRAVE	2,581,208.75	3,204,551.81	3,031,029.98	3,721,617.90	3,917,450.51	3,325,230.30
Donacione / Participime	133,624.77	224,458.04	576,742.06	320,024.71	30,694.18	412,166.96
Gjithsej me Donacione / Participime	2,714,833.52	3,429,009.85	3,607,772.04	4,041,642.61	3,948,144.69	3,737,397.26

INFORMACION MBI TATIMIN NË PRONË

Përgjatë kësaj periudhe raportuese konsiderojmë që stafi i angazhuar në sektorin e tatimit në pronë është treguar shumë efikas, këtë duke u mbështetur në të dhënat e sistemit të tatimit në pronë, konkretisht, regjistrimin e pronave të reja dhe verifikimin e atyre ekzistuese si dhe në të hyrat e realizuara deri në këtë periudhë.

Nëse mbështetemi në të dhëna historike në vitin aktual 2020 të dhënat e tatimit në pronë janë si vijon:

ANKETIMI 2017				
PRONA TË REJA	VERIFIKIMI ME FORMULARË	VERIFIKIMI ME LISTË	VERIFIKIMI TOTALI	VERIFIKIMI + TË REJAT
673	888	6061	6,949	7,622
ANKETIMI 2018				
PRONA TË REJA	VERIFIKIMI ME FORMULARË	VERIFIKIMI ME LISTË	VERIFIKIMI TOTALI	VERIFIKIMI + TË REJAT
721	1436	4848	6,284	7,005
ANKETIMI 2019				
PRONA TË REJA	VERIFIKIMI ME FORMULARË	VERIFIKIMI ME LISTË	VERIFIKIMI TOTALI	VERIFIKIMI + TË REJAT
732	664	5199	5863	5863
ANKETIMI 2020				
PRONA TË REJA	VERIFIKIM NË PAJISJE	VERIFIKIMI ME LISTË	VERIFIKIMI TOTALI	VERIFIKIMI + TË REJAT
567	382	2984	3366	3933

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Projekte Kapitale:

- **Zhvillimi i pikës turistike në Lumin Erenik (faza 3)** – projekti është implementuar.
- **Ura e Fshejtë & Kanioni, ndriçimi, shtegu për ecje** – Projekti është në fazën përfundimtare të implementimit.
- **Shpella e qirave në Gërquinë (Rruga, Shenjzimi, Ndriçimi dhe pastrimi)**- Projekti ka filluar dhe është në fazën e fundit të realizimit.
- **Ndërtimi i Shtegut për ecje dhe çiklizëm Çabrat – Jahoc (Rruga, Shenjzimi dhe mbjellja e drunjëve përgjatë shtegut.** - Projekti është në procedurë të prokurimit.
- **Ndërtimi i Shtegut për ecje dhe çiklizëm Shkugëz - Devë (Rruga, Shenjzimi).** Projekti është në fazën e implementimit.
- **Shpella e Kusarit – Ndriçimi** – janë paraparë 20,000.00 euro, por projekti ka kosto prej 54,000.00 andaj jemi në bisedime me organizatën zvicerane PPSE. Me këtë organizatë jemi duke e shqyrtuar mundësinë e bashkëfinancimit të projektit.

Grantet për Biznese:

Për shkak të COVID-19 është bërë monitorimi i planifikuar për përfituesit e Granteve për Biznese të vitit paraprak, gjegjësisht të vitit 2019. Procesi i monitorimit ka përfunduar në muajin Tetor 2020.

Në muajin Korrik është bërë thirrja për Aplikim për Grante për Biznese për vitin 2020, ku është formuar komisioni i cili në bazë të kriterëve ka përzgjedhur 15 bizneseve përfituese të cilat në total kanë përfituar në vlerë 55,510 €.

Projekti i bashkëfinancuar nga DZHE dhe HELP–KOSOVA, projekt ky i cili ka për qëllim mbështetjen e bizneseve dhe rritjes së kapaciteteve të tyre, përfitues të grantit kanë qenë 37 Biznese nga komuna e Gjakovës , vlera e të cilit ishte 80,000.00 €.

Për shkak të pandemisë Covid 19, me Vendim të Asamblesë Komunale nga rezerva buxhetore janë ndarë mjete në vlerë 200,000.00 €, nga e cila shumë kanë përfituar 318 biznese.

TË HYRAT JANAR - DHJETOR: (taksa në firmë + taksa për zgjatje të orarit të punës)

Mos realizimit i planifikimit është mbyllja nga pandemia covid-19

Të planifikuara	Të realizuara
90,000.00 €	23,067.00 €

Zyra për regjistrimin e bizneseve: (Janar – Dhjetor 2020)

Biznese Individuale B.I	274
Biznese SH.P.K	91
Total biznese të regjistruara:	365
Shuarje e bizneseve	68
Ndërrimi i certifikatave të biznesit	599

Këshilli Publiko – Privat:

Për shkak të pandemisë COVID-19 nuk janë mbajtur takimet e Këshillit Publiko-Privat.

Drejtoria për Shërbime Publike

Në vazhdim në pesë shtylla është paraqitur puna e kryer gjatë vitit 2020 e cila ka qenë pjesë e planeve dhe detyrave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

SEKTORI I INFRASTRUKTURËS - RRUGËVE LOKALE

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2020 është punuar-realizuar me sa vijon:

Janë realizuar-përfunduar këto projekte:

- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Skivjan, Lg=6.540,00 m¹, vlera 851,771.15 €, viti 2013/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Shishmon i Bokes - Mazrek, Lg=2.000,00 m¹, vlera 193,002.77 €, viti 2009/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fsh. Shishmon, lagjja Krazhnje, Lg= 875,50 m¹, vlera 77,490,88 € viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Ramahmat, Lg=2.593.00 m¹, vlera 171,425.15 €, e financuar nga MI, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i Rr. “Kushnini” në fsh. Dol dhe Rr. “Liza Vorfi” në fsh. Kushavec, Aksi 1 Lg=397.25 m¹, Aksi 2 Lg=625.25 m¹ Lg tot= 1.022.25 m¹, vlera 62,390.68 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve ‘7 Gushit’, ‘Dedë Lleshi’ dhe degëzimet e Rr. ‘Marie Kraja’ (e komunitetit minoritar) në fsh. Vraniq, Lg=1250.05 m¹, vlera 140,447.58 € viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në lagjen Beli dhe rrugëve tjera në fshatin Demjan, Lg=2171.50 m¹, vlera 172,937.50 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fshatin Raqë, Lg=1.685.00 m¹, vlera 129,999.70 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Smolicë, (Lagjet Gjoshi, Lataj, Hasanaj dhe Bezhani-Kolonia) Lg=1.178.00 m¹, Rr. “Dëshmorët e Smolicës” dhe “Sokol Nuza” Lg=863.63 m¹, Rr. “Halit Nuza”, Lg=66.00 m¹, vlera 103,019.53 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i Rr. “Rifat Smajli” në fshatin Kralan, Lg=1428.14 m¹, vlera 112,029.32 €, viti 2019/2020;

- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Cërmjan - Meqë, Lg=3255.00 m¹; vlera 343,313.05 € e financuar nga MI, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Marmull, Lg=1.020.67 m¹, vlera 65,377.65 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Nec, Lg=861.61 m¹, vlera 57,854.09 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Cërmjan, Lg=1.784.46 m¹, vlera 123,818.58 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Morinë, (aksi1,2 deri në profilin P14 dhe aksi 3, 3') Lg=1.007.00 m¹, vlera 85,829.98 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i Rr. "Muharrem Domi", Lg=715,40 m¹, vlera 155,555.55 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Bec, Lagjja Hajdaraj, Aksi 30 Lg=1.207.34 m¹ Aksi 31 Lg=167.00 m¹, vlera 92,659.09 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Osek Hylë (Rr. "Artan Zheli"), Lg=1.495.15 m¹, vlera 103,157.89 €, viti 2019;
- Ndërtimi-shtruarja me kubëza graniti i rrugëve, kanalizimit fekal - atmosferik dhe ujësjellësit në "Qarshinë e Vjetër" Rr. "Bajram Daklani" Lg=204.22 m¹, Rr. "Tefik Çanga" Lg=135.65 m¹, Rr. "Qazim Bakalli" Lg=128.51 m¹, Rr. "Abedin Terbeshi" Lg=264.68 m¹ dhe Rr. "Vëllezërit Frashëri" Lg=123.68 m¹, lg.tot=676.74 m¹ vlera 178,232.59 €, viti 2019/2020;
- Rregullimi i shtratit të Lumit "Krena"- pjesa tretë (nga ura në rrugën "M. Lakuci" deri në urën e "Taliqit") Gjakovë, Lg=532.50 m¹, vlera 788,888.88, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Korenicë, Lg=1.479.88 m¹, vlera 93,668.06 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Ramoc, Lg=1.673.00 m¹, vlera 114,941.60 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fshatin Bishtazhin, Lg=550.00 m¹, vlera 50,000.00 €, viti 2020, financim nga vetë komuniteti;
- Ndërtimi i udhëkryqit dhe zgjerimi i segmentit të ish Rr. "Nëna Terezë" (Rr. "Bardhyl Qaushi" nga semaforët deri te Gjykata) me infrastrukturë, Lg=283.00 m¹, vlera 158,158.03 €, viti 2015/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fsh. Brekoc (lagjja Muqaj dhe Jetishi), Lg=2.480.39 m¹, vlera 172,623.91 €, viti 2017/2020;

- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fsh. Pnish-Demjan 2 (lagjja Ramadan Iseni), Lg=1.705.00 m¹, vlera 98,560.75 €, viti 2020.
- Ri-ndërtimi-asfaltimi i Rr. “Fan Noli” dhe një segmenti të Rr.“Tefik Çanga” dhe shtruarja e trotuarit, Lg=270.00 m¹, vlera 17,000.00 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës “Luftëtarët Nimanaj” në fsh. Gërgoc, Lg=1.213.50 m¹, vlera 89,967.57 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Bordosanë, Lg=1.456.00 m¹, vlera 98,371.25 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës “Dervish Shaqa” në fsh. Osek Hylë, Lg=1.141.00 m¹, vlera 78,521.30 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Rracaj – Rripaj, Lg=1.092.00 m¹, vlera 104,881.00 €, viti 2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në Piskotë - Dardani, Lg=608.00 m¹, vlera 13,909.77 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në “Çabrat (Rrugët:“Selim Gjoci”, “Arben Saliuka”, “Hazyr Këpuska”, “Islom Koci”, “Hafiz Guta”, “Rilindja”, “Qazim Grezda”, “Martirët e Lirisë”, “Skënder Shehu” dhe një segment i rrugës “Bajram Curri”), Lg=1.511.60 m¹, vlera 186,689.66 €, viti 2020;
- Ndërtimi-shtruarja me kubëza graniti e rrugëve në “Çarshinë e Vjetër” dhe infrastruktura përcjellëse (Rrugët: “Izet Hima”, “Tahir Efendijs”, “Remzi Pula”, “Sefedin Xërxa”, “Mejtepi Ruzhdije”, “Tefik Çanga”, “Ismail Qemali”, “Sylejman Vokshi” dhe “Esat Kryeziu”), Lg=1.700.00 m¹, vlera 428,077.48 €, viti 2020, bashkë financim me DEMOS-in dhe MAPL-në;
- Ndërtimi i kanalizimit (vendosja e gypave) në Rr. “Gaspër Karaqi”, Lg=7.800.00 m¹, vlera 62,988.08 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) te “Çarshia e Jupave”, vlera 799.91 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Sopot, Lg=1.000.00 m¹, vlera 24,178.00 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Nivokaz, Lg=267.00 m¹, vlera 6,349.41 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Novosellë, Lg=325.00 m¹, vlera 7,424.67 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit (gypa betoni Ø 1000 mm) në fsh. Dujakë, Lg=100.00 m¹, vlera 5,784.04 €, viti 2019/2020;

- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Bec, Lg=360.00 m¹, vlera 8,723.48 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Brekoc lagjja Pepaj - Jetishi, Lg=38.00 m¹, vlera 3,346.73 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Hereq, Lg=60.00 m¹, vlera 1,664.16 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Lugbunar, Lg=324.00 m¹, vlera 5,093.90 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit (gypa betoni Ø 1000 mm) në fsh. Madanaj, Lg=84.00 m¹, vlera 2,979.62 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Palabardh, Lg=180.00 m¹, vlera 1,664.16 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Planqor, Lg=615.00 m¹, vlera 13,948.97 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Rogovë, Lg=200.00 m¹, vlera 3,539.80 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit (gypa betoni Ø 1000 mm) në fsh. Zhabel, Lg=58.00 m¹, vlera 2,562.95 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi i kanalizimit në Parkun e Qytetit, Lg=110.00 m¹, vlera 1,650.33 €, viti 2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) te Shkollat e Mesme, Lg=220.00 m¹, vlera 6,667.00 €, viti 2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në Rr. “Nëna Terezë” (te Xhamia), Lg=100.00 m¹, vlera 3,031.30 €, viti 2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në Rr. “Dëshmorët e Dujakës” Lg=90.00 m¹, vlera 1,028.00 €, viti 2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në Rr. “Martirët e Dubravës” Lg=450.00 m¹, vlera 12,400.00 €, viti 2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Shishmon, Lg= 900.00 m¹, vlera 27,452.89 €, viti 2020;

- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Pjetërshan, Lg= 350.00 m¹, vlera 8,620.05 €, viti 2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza) në fsh. Skivjan, Lg= 450.00 m¹, vlera 12,327.19 €, viti 2020;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza dhe gropës septike-impianitit) në lagjen “Ali Ibra”, Lg=361.50 m¹;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fsh. Osek Hylë (faza II), Lg=2.500.00 m¹, vlera 24,611.00 €, viti 2020, bashkëfinancim me KRU “GJAKOVA”.
- Renovimi i segmentit të rrugës R-203 Gjakovë – Qafë Prush, Lg=2.2 km¹ (shtresa e dytë e asfaltit), vlera 65,000.00 €, financim nga MI viti 2020;
- Ndërtimi-shtruarja me kubëza betoni e rrugëve në fsh. Botushë, Lg=2.020.00 m¹, vlera 224,559.78 €, viti 2019;
- Ndërtimi-shtruarja me kubëza betoni e trotuareve në rrugët “Ismajl Qemajli”, “Remzi Pula”, “Vëllezërit Frashëri”, “Mejtepi Ruzhdie”, “Sefedin Xërxa” dhe Sheshi i sajë, L=1.670.00 m¹ viti, 2020, vlera 102,114.77 €;
- Ndërtimi-shtruarja me kubëza betoni e trotuareve në rrugët ”Ymer Prizreni”, “Jahë Salihu”, “Ilir Soba” dhe Sheshi i saj, L=670.00 m¹ viti, 2020, vlera 52,083.58 €;
- Ndërtimi-shtruarja me kubëza betoni e trotuareve në rrugët ”Ymer Prizreni”, “Jahë Salihu”, “Ilir Soba” dhe Sheshi i saj, L=670.00 m¹ viti, 2020, vlera 52,083.58 €;
- Ndërtimi-shtruarja me kubëza betoni e trotuareve në Rr. "Sylejmon Lleshi", "Sylejmon Vokshi" dhe sheshi i saj, rrugën "Ekrem Kryeziu", rrugën te "Hendikosi", sheshi i Rr. "Ilir Soba" 2 dhe platoja te shkolla "Zef Lush Marku" në Brekoc në Brekoc Lg=920.00 m¹, vlera 54,816.50 €, viti 2020;
- Sanimi – zgjerimi i Urës, ndërtimi i krihëve dhe murit mbrojtës, në fsh. Pjetërshan me kontratë të mirëmbajtjes vjetore, viti 2020, vlera 5,300.00 €;
- Ndërtimi i Urës në fsh. Morinë me kontratë të mirëmbajtjes vjetore, viti 2020, vlera 10,125.38 €;
- Sanimi i shputës së shtyllës së Urës në fsh. Duzhnje - Babaj Bokës dhe Urës në fsh. Shishman-Babaj Bokës me kontratë të mirëmbajtjes vjetore, viti 2020, vlera 7,250.00 €;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fsh. Cërmjan, Lg= 450.00 m¹, vlera 36,075.00 €, viti 2020.

Janë në përfundim këto punime - projekte:

- Ndërtimi-asfaltimi i Rr." Petro Nini Luarasi" (segmenti 2, Lg=364,40 m¹ dhe segmenti 3, Lg=385,28 m¹ si dhe ndërtimi i kanalizimit atmosferik), vlera 189 223,37 €, viti 2017/2020;
- Zgjerimi i segmentit të Rr. "Nëna Terezë" (Qendër), Lg=596.43 m¹, vlera 310,821.04 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës te Pika e Zezë, Lg=550.00 m¹, ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik, vlera 99,358.22 €, viti 2020;

Janë në realizim-vazhdim këto punime - projekte:

- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fsh. Doblibare, Lg=4.883,75 m¹, vlera 598,761.63 €, viti 2013/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fsh. Dobrigje, Lg=1.270,00 m¹, vlera 192,176.00 €, viti 2013/2020;
- Ndërtimi i Qarkores së Gjakovës (Lot 1) rruga me infrastrukturë, Lg=2.100,00 m¹ dhe ura Lg = 36,00 m¹, vlera 2,167,951.71 €, viti 2018/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi i Parkut të Qytetit, vlera 362,388.18 €, viti 2019 deri 2021;
- "Eliminimi i ujërave të ndotura në Jug-Perëndim të Kosovës Faza III – Gjakovë" Ndërtimi i Impiantit për pastrimin e ujërave të zeza Gjakovë, vlera 7 386 000,00 € financim nga KFW, SDS, MMPH, Komuna Gjakovë dhe KRU "Gjakova", viti 2018/2020;
- Rehabilitimi dhe shtimi i Rrjetit të Kanalizimit Gjakovë (Kolektori I, Lg = 3.00 km dhe Kolektori II, Lg=7.00 km), vlera 3,695,933.26 €, financim nga KFW, KRU "Gjakova", viti 2018/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Smolicë - Nivokaz, Lg=6.008,00 m¹, vlera 702,000.00 €, viti 2018/2020, financim nga MI;
- Rikonstruktimi-Rindërtimi i rrugës Regjionale R-112 Bishtazhin - Demjan, Lg=12.60 km¹, vlera 1,700 000,00 €, viti 2018/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Shqiponjë - Krelan, Lg=3948.57 m¹ dhe rrugës Shaban Zeka Lg=2657.66 m¹, vlera 790,710.24 € e financuar nga MI, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës së Radoniqit, Lg=3.860.25 m¹, vlera 499,862.39 €, viti 2020, financim nga MI;

- Zgjerimi i rrugës M - 9/1 Gjakovë - Dollc (Segmenti i parë, nga Pika e Zezë deri te Ura në Rakovinë), Lg=5.000,00 m¹, vlera 4,000,000.00 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Rakovinë, Lg=1151.17 m¹; vlera 87,577.02 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Shqiponjë, Lg=1459.29 m¹, vlera 111,989.69 €, viti 2019/2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Dol - Lipovec, Gjakovë Lg=3.096,00 m¹, vlera 255,555.55 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden, Lg=2.197.00 m¹; vlera 343,313.05 €, viti 2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i Rr. “Lugu i mirë” në fsh. Pjetershan Lg=1.546,17 m¹, vlera 155,154.42 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Hereq (Pjesa 1) Lg=1.983.18 m¹, vlera 123,407.03 € dhe (Pjesa 2) Lg=1.755.48 m¹, vlera 116,404.96 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Novosellë, Lg=3.554.17 m¹, vlera 242,120.91 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Janosh, Lg=2.196.20 m¹, vlera 137,293.05 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Novosellë – Dobrigje deri te Shkolla, Lg=2.107.97 m¹, vlera 162,714.11 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës së peshkut në fshatin Babaj Bokës Lg=2.911.13 m¹, vlera 288,502.02 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi i Qarkores së Gjakovës – Rr. “Bujar Roka” (Segmenti i dytë) rruga me infrastrukturë, Lg=2.731,00 m¹, rrugët ndihmëse Lg=360,70 m¹, Trotualet, ndriçimi, ura Lg=27,10 m¹, kanalizimi atmosferik, Lg=2.884.00m¹, ujësjellësi, Lg=292.00 m¹, vlera 3,580,435.49 €, viti 2019/2020, financim nga MI;
- Ndërtimi-asfaltimi i Rr. “Dëshmorët e Rogovës” (ish Rr. “Ali Ibra”), Lg=432.50 m¹, vlera 87,246.76 €, viti 2020;
- Ndërtimi- asfaltimi i segmentit të rrugës nga rruga Transit “Avdullah Babalija” deri te banesat e banimit social, Lg=245.50 m¹, vlera 57,675.42 €, viti 2020.

- Zgjerimi i segmentit të Rr. “Nëna Terezë” (Qendër), Lg=596.43 m¹, vlera 310,821.04 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Piskotë, Lg=630.00 m¹, vlera 144,898.33 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës “Nikollë Dodaj” në fsh. Dujakë, Lg=1.200.00 m¹ dhe ndërt. kanaleve të ujit Lg=400.00 m¹, vlera 72,050.45 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Gërquinë, Lg=1.254.62 m¹, vlera 89,634.98 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Bitesh, Lg=1.000.00 m¹, vlera 66,099.50 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Demjan (Lagjja e Shehut), Lg=2.291.00 m¹, vlera 123,342.70 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Shishman, Lg=2.705.00 m¹, vlera 137,581.65 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Brovinë, Lg=1.007.00 m¹ dhe ndërtimi i urës, vlera 64,328.10 €, viti 2020;
- Ndërtimi i murit mbrojtës (Lg=535.00 m¹) dhe sanimi i rrugës në fsh. Kushavec, Lg=80.00 m¹, vlera 137,581.65 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Rogovë, Lg= 2.286.50m¹, vlera 111,111.10 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fsh. Skivjan, Lg=2.778.03 m¹, vlera 196,758.67 €, viti 2020;
- Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fsh. Devë, Lagjja Kukaj, Lg=624.15 m¹, vlera 35,000.00 €, viti 2020;
- Ndërtimi i shtratit të Lumit “Gusha” Lg= (2 x 52.50)=105.00 m¹, vlera 9713.55 €, viti 2020;
- Ndërtimi-shtruarja me kubëza betoni e trotuareve në Rr. "Kongresi i Manastirit", Rr."Vashingtoni", Rr. "Nëna Terezë", Lg=1.693.00 m¹, vlera 111,738.00 €, viti 2020.

Përblëdhje:

• Rrugë të shtruara me asfalt	49.20 km ¹
• Rrugë të shtruara me kubëza betoni dhe graniti	4.40 km ¹
• Trotuare	4.90 km ¹
• Sanimi dhe ndërtimi i urave	4 copë
• Rrjetë i kanalizimit	22.40 km ¹
• Rrjetë i ujësjellësit	5.40 km ¹
• Rregullimi i Shtratit të Lumit “KRENA”	532 m ¹

SEKTORI PËR PARQE, TREGJE DHE VARREZA

- Përcjellja e menaxhimit të tregjeve (Orize, Tregu Rogovë, S.Stavileci)
- Përcjellja e mirëmbajtjes së gjelbërimit të qytetit (Punët po bëhen nga K.R.M. “ÇABRATI”)
- Përgatitje e dokumentacionit për shpalljen e ankandit publik për tregun “Orize”
- Përcjellja e punëve në ndërtimin e kanalizimeve në zonën urbane dhe rurale
- Përcjellja e punimeve në ndërtimin dhe sanimin e parqeve
- Përcjellja e punimeve në furnizimin dhe montimin e ulësve dhe shportave në parqet publike

TË HYRAT E KRIJUARA NGA TREGJET

Tregu „ORIZE”	12 muaj x 415 euro = 4,980 euro
Tregu „S. Stavileci”	12 muaj x 1250 euro = 15,000 euro
Tregu „Rogove”	<u>4 muaj x 620 euro = 2,480 euro</u>
TOTALI:	22,460 EURO

SEKTORI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE DHE AMBIENTIT

Gjatë periudhës së parë të vitit 2020, gjegjësisht periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020 është realizuar:

- Është planifikuar Gara për Gjakovë të pastër, mirëpo për shkak të pandemisë ka mbetur pezull (Nuk është realizuar)
- Pilot projekti, ndarja e mbeturinave të riciklueshme në burim (shkollat, biznese dhe amvisëri) – Donacion Giz, në vazhdimësi
- Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave 2021-2025 , në bashkëpunim me GIZ Gjerman (Në proces) – Donacion Giz, (Për shkak të pandemisë nuk kemi arritur ta përfundojmë
- Taksat dhe tarifat për Amvisëri dhe Biznese, në bashkëpunim me KRM Çabrati (E përfunduar)
- Rregullorja Komunale për menaxhimin e mbeturinave

- Projekti i përbashkët me Let's do it Peja (bashkëpunimi ndërajonal me komunën e Pjetnices) – në proces Donacion IPA II
- Shpërndarje e Kontejnerëve në Rajonin e Rekës së Mirë – 10.000 €, shtrirja e shërbimit nga KRM Çabrati
- Përfitimi i 300 komposterëve shtëpiak – Donacion Giz 15.000 € (E përfunduar)
- Pastrimi i stacionit stacionit transfer 460.000 € (në përfundim të procesit)
- Hartimi i Koncept Planeve - Hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave - Hartimi i koncept planit për hartimin e mbeturinave të vëllimshme - Hartimi i koncept planit për menaxhimin e mbeturinave të ngurta - krijimi i databazës dhe analizën teknike të ekonomive familjare dhe bizneseve në menaxhimin e mbeturinave, bashkëpunim me GAC. Është planifikuar që të organizohet prezentimi nga ana e GAC, për tu integruar në PLMM 2021-2025, mirëpo për shkak të pandemisë është shtyrë për janar 2021.
- Në proces të verifikimit të deponisë për mbetje inerte

SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK DHE NGROHJES

7539.75 Janar, Sit 19

- Gjakovë: “Ylber Hoxha”, “Rr. Berisha”, “D. Pergega”, “ V. Kajtazi”, “Parku prapa pallatit të Kulturës”, “F. Imami”, “ Sh, Shasivari”, “K. Binxhia”, “Gj. N. Kazazi”, “Y. e Erenikut”, “ F. Agani”, “Skenderbeu”, “ M. Teutë”, “Y. Domi”, “B. Çausi”, “D. e Hereqit”, “Uçk”, “D. Vokshi”, “B. Bistrzhini”, “Urim Rexha”.
- Fshatrat : Sheremet, Korenicë, Zhub, Vogovë, Bec, Meje, ,Cërmjan, Bardhaniq, Jabllanicë, Skivjan, B.Bokes, Pjetershan

6729.6 Euro, Shkurt, Sit 20

- Gjakovë: “M. Lleshi”, “J. Krasniqi”, “D. Vula”, “Uçk”, “Y. Pula”, “F .Domi”, “F. Salihu”, “A. P. Tepelena”, “B. Curri”, “ T. Gjoka”, “ A. Gjikolli”, “I. Prizrenit”, “Migjeni”
- Fshatrat: Rogovë, disa rrugë, Piskotë, Smolicë, Nec, Smaq, Muhadër, Pjetërshan, Ramoc, Lipovec, Bishtazhin, Ramamat, Lugbunar, Cërmjan, Batush, Molliq, Bec, Meje, Sopot- Korenicë,

Hereq, Rracaj, Osek Hylë, Bitesh, Lipovec, Brovinë, Molliq, Jabllanicë, Nec, Kralan Gërgoc, Cërmjan,

20,445.75 euro Sit. 21, Mars

- Gjakovë: "K. Binxhia", "B. Imami", "M. C .Hafizi", "U. Bytyqi," "B. Curri", "M. Frashëri", "Anton Çetta", parku I banesave te solidaritet.
- Ne Fshatrat: B.Bokes, Mehje, Rogove ne disa rruge

8,695.90 euro, Sit 22

- Gjakovë: Urim Bytyqi, I.Aslani, Migjeni, A.Blyta, K.Kristifor.B.Roka,B.Imami, F.AganiH.Zeka, Yll.Morina, Sh.Polluzha, M.Zajmi, D.e Morines, Gj.N.Kazazi,M.Teuta, Qameria, Mon Maqi, A.Delija, I.Krasniqi, D.Zeneli, D.Vula, R.Pula,M.Zajmi,E.Duraku, V.Shita, A.Lama,
- Fshatrat: Lipovec, Orize, Dobrixhe, Fshaj, Shkugez, Rogovëne disa rruge, Fsh,Orize, Raqe, Planqor, Smolice, Molliq,

11,584.90 Euro, Sit.23

- Gjakovë: M.Barleti, K.Uka, L.Gurakuqi, J.Zherrka, Gj.Buzuku, V.Miftari, D.e Lirise, D.D.Danes, Gj,Sereqi, A.Dreni, M.Malota, P.Kllementi, Minatori, isa Grezda, H.Zeka, D.Hereqit, D. e Crmjanirt, A.Delija, A.Hasi, Shpallaska, M.Spahija, I.Fehmiu, I.Palaj, Latif Shaqiri
- Fshatrat: Skivjan, Crmjan, Ponoshec, brekoc, N.E Eperme, N. e Ulet, Shkugez, Zhabel, Bishtazhin, Lipovec, Vraniq, Trakaniq, N.e eperme, Nec, Jahoc, Ramoc, Rracaj, Hereq, Skivjan, brovine, Babaj I Bokes.

19,736.45 Euro, Korrik Sit 1

- Gjakovë: Ismet Jashari, Agim Deva, M.Myrta, L.Pozhegu, Adem Delija, M.Ukshini, A,Zeneli, Rexhep Tafa, I.Soba, L.Dugagjini, Z.Nimani, M.Hagjiu, S.Stavileci, Y.Prizreni, S.Llagami, Londra, F.Konica, J.Saliu
- Fshatrat: Qerim, Molliq, Gerqin, Planqor, Mehje, Skivjan, Dol, Shishmon, Bec, Mehje, Brovinë, Fshaj, Vogovë

19,993.20 Euro, Gusht Shtator, Sit 2

- Gjakovë: F.Saliu, S.Rama, A.Lama, Parku N.Tereza, H.Guta, P.Vula, B.Curri, Gj.Buzuku, V.Makla, H.Spahija, M.Miftari, Londra, V.Kajtazi, N.Maloku, E.Gjika, G.Terbeshi, S.Riza, L.Prizrenit, Gj.Bisaku, T.Qanga, R.Tafa, M.Malota, UQK, M.Lleshi, D.Zeneli, N.Pozhari, P.Klementi, S.Xrxa, te pazari bl.i ri, A.Terbeshi, I.Efendija K.Bingjija, M. Canhafizi, Tivari, A.Jashari, Sh, Alija,
- Fshatrat: Hereq, Batush, Brekoc, Vogov, Shkugës, Skivjan, Gerqin, Lipovec, Sheremet, Crmjan, Zhdredh, Bardhaniq, Zhabel, B.Bokës, Pjetershan, Krelan, Duzhnje, Osek Hil, Bishtazhin, Palabardh, Popoc

94,725.55 euro investim në mirëmbajtje

Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik 2020

49,977.32 Euro, Sit. 3

- Gjakovë: (Avni Rrustemi, Ahmet Gjiko, Sadedin Shehu, Marie Shllaku, Edit Durham, Muslim Mulliqi, S.Shehu, deg. Tirana, Behije Dashi)
- Fshatra: Goden, Planqor, Korenice, Dujake, Devë

20,833.50 Euro Sit. 4

- Gjakovë: “I.Ahmeti”, “H.Dobruna”, “Lidhja e Prizrenit”, “U. Bytyqi”, “Xhemail Abdullahu”, “D. Gj .Luli”, “Zenel Dana”, “B.Shala”
- Fshatrat: Gerqine, Brovine, Stubell, Lipovec, Vraniq, Duzhnje

10,461.4 Euro, Sit 5

- Gjakovë: “Sh. Polluzha”, “H. Dobruna”, “A. Jashari”, “UÇK”, “Vëllezrit Abdullahu”
- Fshatrat: Ramoc

19,754.15 Euro , Sit 6

- Gjakovë: “Elton Zherka”, “Marin Barleti”

19,947.30 Euro Sit. 7

- Gjakovë: “Remzi Pula”, “Ismail Qemajli”, “Sefedin Xërxa”
- Fshatrat: Hereq, Lugbunar-Sh.Krasniqi

19,999.95 Euro, Sit 8

- Gjakovë: “Agim Haxhiavdyli”, “Adem Delija”, “Mic Sokoli”, “Te Bakija”, “Ferhat Binishi”
- Fshatrat: Doblibare, Sopot, Planqor

140,973.62 Euro Gjithsej investime në zgjerim

SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

- Menaxhimi i trafikut: Në bashkëpunim me zyrtarët policor, janë realizuar veprime për mbarëvajtje të trafikut, duke rregulluar dhe planifikuar rrjedhën e trafikut gjatë punimeve dhe në pika ku ka pasur fluks më të madh.
- Lëshimi i lejeve për qarkullim dhe furnizim, me kërkesë të operatorëve transportues, banorëve të rrugëve dhe punonjësve të rrugëve ku është i ndaluar qarkullimi.
- Transporti i udhëtarëve: me kërkesë të operatorëve janë vazhduar rendet e udhëtimit në relacione të ndryshme në transportin urbano-periferik. Si dhe janë lëshuar rende të reja të udhëtimit sipas kërkesave. Po ashtu në vazhdimësi do të inspektohet operimi i këtyre linjave.
- Leje për ndalim të qarkullimit: me kërkesë të organizatorëve të ngjarjeve sportive dhe kulturore janë lëshuar leje për ndalim të përkohshëm të qarkullimit në segmente të ndryshme.
- Inspektimi: është bërë inspektimi periodik i operatorëve të transportit të udhëtarëve duke përfshirë edhe shërbimin taxi, po ashtu janë inspektuar në vazhdimësi rrugët dhe siguria rrugore duke bashkëpunuar ngushtë me stacionin policor në Gjakovë dhe Njësinë e Trafikut Rrugor për rajonin e Gjakovës.
- Janë mirëmbajtur dhe sanuar semaforët në kryqëzimet ekzistuese sipas nevojës
- Janë vendosur dhe riparuar shenjat e sinjalizimit vertikal sipas nevojës.

- Menaxhimi i kontratave: Janë menaxhuar dhe mbikëqyrur kontrata, në të cilat stafi i sektorit është i përfshirë si menaxher apo anëtarë të komisionit p.sh.: Kontrata e mirëmbajtjes së rrugëve, gjatë stinës verore dhe dimërore, kontrata e mirëmbajtjes së rrugëve me asfalt dhe zhavor, kontrata e projektimit të projekteve në ndërtimin e ulët dhe të lartë etj.
- Menaxhimi i projekteve të ndërtimit të ulët dhe të lartë: Janë menaxhuar projektet e projektuara nga operatorët e kontraktuar. Janë dhënë propozime të reja për projektet e infrastrukturës rrugore, të cilat pas pranimit, janë përgatitur për tenderim sipas nevojës.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

INVESTIMET KAPITALE

Nuk janë paraparë investime kapitale për periudhën Janar – Dhjetor 2020

SHPRONËSIMET

Raport i gjendjes së shpronësimit “Qarkorja e Qytetit”

Totali €	Vlerësimi sipas MF	E realizuar	Mbetet për pagesë
	1,217,192.00	70%	30%

Vazhdimi i rrugës “Bujar Roka 2”

Totali €	Vlerësimi sipas MF	E realizuar	Mbetet për pagesë
	487,385.00	0 €	487,385.00

Rruga për varrezat e Martirëve - Çabrat

Totali €	Vlerësimi sipas MF	E realizuar	Mbetet për pagesë
	114,412.00	47,560.00 €	66,852

Vazhdimi i rrugës “Muharrem Domi”

Totali €	Vlerësimi sipas MF	E realizuar	Mbetet për pagesë
	136,435.00	0 €	136,435.00

Ndërtimi i segmentit të rrugës "Banesat Sociale"

Totali €	Vlerësimi sipas MF	E realizuar	Mbetet për pagesë
	213,720.00	0 €	213,720.00

Projekti i rrugës Tranzite në Rezinë (Pika e zezë- Nakaradë)

Totali €	Vlerësimi sipas MF	E realizuar	Mbetet për pagesë
	2,562,881.00	159,326,37 €	2,403,555.00

Segmenti i rrugës "Marije Shllaku"

Totali €	Vlerësimi sipas MF	E realizuar	Mbetet për pagesë
	23,130.00	0 €	23,130.00

REALIZIMI I TË HYRAVE

Burimet e të ardhurave	Planifikimi Janar Dhjetor 2020	Realizimi Janar Dhjetor 2020	Përqindja e realizimit Janar Dhjetor 2020
Të hyrat nga shërbimet kadastrale	170,000.00	151,457.00	89%

ZYRA LIGJORE

Muaji & Viti	Numri i lëndëve me karakter juridik	Të zgjidhura	Të pa zgjidhura	Me mungesa
Janar- Dhjetor 2020	1548 lëndë	1517 lëndë	31 lëndë	31 lëndë
Përqindje (%)	100 %	98 %	2 %	

AKTIVITETE TJERA

- Përpunimi dhe menaxhimi i lëndëve në SIKTK – harta kadastrale: si ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, modifikim i attributeve të parcelave, modifikim i attributeve të ndërtesës, regjistrimi i ndërtesave – objekteve, rregullim kufiri etj
- Krijimi dhe lëshimi i kopjeve të planit
- Konsultime me palë në zyrën e pranimit

- Dalja në terren për rilevimin e terrenit, vetëm me kërkesë nga Drejtoritë pranë KK-Gjakovë
- Përpunimi teknik i lëndëve të terrenit në zyre – (Përpunimi i manualeve për ndarje dhe bashkim të parcelave, rregullimi i kufijve ndërmjet dy parcelave etj.)
- Dalja në terren me kërkesë të Gjykatës Themelore – Gjakovë, respektivisht përpunimin e ekspertizave
- Përgatitja e dokumentacionit për poligonin ushtarak për FSK-në respektivisht Ministrinë e Mbrojtjes.
- Përgatitja e elaboratit për segmentin e tretë të Lumit “Krena” – Prej rrugës “Mazllom Lakuci” deri tek ura e Taliqit
- Rilevimi i gjendjes faktike, respektivisht krijimi i plan situacionit për Institucionin Parashkollor ” Ganimete Tërbeshi”
- Rilevimi i gjendjes faktike, respektivisht krijimi i plan situacionit për ” Hendikosin”
- Rilevimi i gjendjes faktike, respektivisht krijimi i plan situacionit për Shkollën e mesme normale “Nexhmedin Nixha” dhe definimi i kufirit kadastral me QMF-në (Qendrën e Mjekësisë Familjare)
- Rilevimi i gjendjes faktike, respektivisht krijimi i plan situacionit për kërkesën e Drejtorisë së Rinisë dhe Kulturës dhe Sportit (3 lokacione – gjendje faktike të matura)
- Rilevimi i gjendjes faktike, respektivisht krijimi i plan situacionit për shkollën fillore në Damjan
- Përgatitja e elaboratit për rindërtimin e zonave kadastrale, sipas kërkesës së AKK-Agjensionit Kadastral i Kosovës

RAPORTI NGA REGJISTRIMET NË RDPP-në nga Drejtoria për Gjeodezi , Kadastër dhe Pronë Periudha - Janar - Dhjetor 2020		
Nr.Rendor	Lloji i regjistrimit	Gjithsej numri i regjistrimeve
1	<i>Ndarjet e parcelave</i>	254
2	<i>Bashkimi i parcelave</i>	73
3	<i>Regjistrimi i ndërtesave</i>	116
4	<i>Ndarja e ndërtesave</i>	73
5	<i>Bashkimi i ndërtesave</i>	73
6	<i>Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave</i>	80
7	<i>Ndarja e pjesëve të ndërtesave</i>	73
8	<i>Bashkimi i pjesëve të ndërtesave</i>	73
9	<i>Regjistrimi i hipotekave</i>	129
10	<i>Çregjistrimi i hipotekave</i>	133
11	<i>Regjistrim i shitblerjeve</i>	385
12	<i>Regjistrimi i trashëgimive</i>	225
13	<i>Regjistrim i faljeve të pronës së paluajtshme</i>	191
14	<i>Regjistrimi i ndërrimit të pronave të paluajtshme</i>	73
15	<i>Regjistrimi i shkëputjes së bashkësisë familiare</i>	73
16	<i>Regjistrimi i përkujdesjes së përjetshme</i>	73
17	<i>Regjistrimi i pronave të ekspropriuara</i>	73
18	<i>Regjistrimi i servitudeve</i>	73
19	<i>Çregjistrimi i Servitudeve</i>	73
20	<i>Regjistrimi i tatimit në pronë</i>	73

21	<i>Çregjistrimi i tatimit ne pronë</i>	73
22	<i>Regjistrimi i barrës tatimore</i>	92
23	<i>Çregjistrimi i barrës tatimore</i>	75
24	<i>Regjistrimi i ngarkesave tjera</i>	73
25	<i>Çregjistrimi i ngarkesave tjera</i>	73
26	<i>Regjistrimi i qirambajtjeve (mbi tre vite)</i>	73
27	<i>Çregjistrimi i qirambajtjeve (mbi tre vite)</i>	73
28	<i>Regjistrimi korrigjimeve në regjistër</i>	89
29	<i>Regjistrimi i rregullimit të kufirit</i>	73
30	<i>Regjistrimi i ndërrimit të shfrytëzimit aktual</i>	73
31	<i>Regjistrimi i shërbimeve tjera</i>	179
	Komulativi:	3335
a.-	Shuma e pronave të hipotekuara (gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020) €	22,202,587.20

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

- Zhvillimi i takimeve të rregullta, ndarja dhe shqyrtimi i mbi 1019 kërkesave - lëndëve të parashtruara pranë DUMM-së gjatë kësaj periudhe dhe atyre të bartura nga vitit paraprak;
- Konsultimet e përditshme me qytetarë dhe dhënia e informatave lidhur me kërkesat e ndryshme;
- Takim me palët për të gjitha lëndët e rregullta dhe;
- Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me Drejtoritë Komunale për projektet kapitale ku pjesëmarrja e DUMM-së me fushëveprimin e saj është e domosdoshme.

Nga aktivitetet tjera të sektorin për urbanizëm, infrastrukturë dhe fusha e mbrojtjes së mjedisit:

- Konsultimet dhe takimet e rregullta me Grupet Punuese për punimin e Hartës Zonale dhe Planit Zhvillimor Komunal.
- Drafti i parë i **Profilit Komunal** fillimisht është diskutuar me grupet punues në takimet e mbajtura me dt.17-22.06.2020 dhe është shpallur në web-faqen e komunës për diskutim prej dt. 13-24.07.2020
- Është vazhduar me punimin e **Vlerësimit të gjendjes** i cili gjithashtu është diskutuar me grupet punuese në takimet e mbajtura me dt. 21-23.09.2020, kurse në web-faqen e komunës është shpallur me dt. 19-30.10.2020.
- Më pas është vazhduar me punimin e **Kornizes së Zhvillimit Hapësinor** për të cilën është mbajtur edhe një work-shop me dt. 21-23.10.2020 me ç'rast është caktuar **Vizioni i Komunës, Qëllimet dhe Objektivat me prioritet.**
- Është përfunduar drafti i **Planit Zhvillimor Komunal** dhe i njëjti është shpallur në Web-faqe të komunës i cili mbetet i hapur prej dt.07-18.12.2020.
- Në të njëjtën kohë në mënyrë paralele po punohet edhe në punimin e **Hartës Zonale** dhe deri më tani janë përfunduar këto pozicione:
 - ✓ Kushtet e përgjithshme për zhvillim për të gjitha zonat e **HZK-së**;
 - ✓ Lista e zonave dhe lista e zonave mbishtresore të **HZK-së**
 - ✓ Zonat e destinuara dhe kushtet zhvillimore përfshirë kushtet ndërtimore të **HZK-së**;
 - ✓ Zonat mbishtresore dhe kushtet zhvillimore.

✓ Pjesëmarrja në Komisionin për pranimin e projekteve zbatuese për ndërtimin e lartë dhe renovimin e objekteve.

- Pjesëmarrja në hartimin e **Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave**;
- Monitorimi i gjendjes së mjedisit, aktivitet i rregullt periodik;
- Eksplorimi, analiza dhe përcaktimi i lokacioneve për pikat grumbulluese të mbeturinave tek objektet e banimit ose shumë banesore;
- Pjesëmarrja e vazhdueshme në **Komisionin për trajtimin dhe miratimin e Raporteve për Leje mjedisore Komunale**;
- Pjesëmarrja e vazhdueshme në **Komision dhe përgatitja e mendimeve profesionale lidhur me parcelat e kompleksit Rezinë veriore**.

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT										
Raport i lëndëve për periudhën nga 03.01.2020 deri më 09.12.2020										
	LLOJI I KËRKESËS	Gjithsejt	POZITIVE	REFUZIM	NDERPRER. PROCEDUR	TERHEQET NGA PRO. CEDURA	PËRGJIGJE, NJOFTIME, PEZULLIME	LISTA E PRITJES	NE PRO. CEDURE	TOTALI
1	KUSHTET E NDERTIMIT	177	85	2					24	177
2	LEJET E NDERTIMIT	176	58	5					23	176
3	NDARJET FIZIKE	8		4		3	1			8
4	EKSTRAKTET	26	23			2				26
5	LEJE PËRDORIMI	22	15						7	22
6	ZGJATJE AFATI LEJES	5	4						1	5
7	LEGALIZIM	221	116			12		25	58	221
8	LEJE MJEDISORE	41	35						6	41
8	TË TJERA	288	246			15	25	1	5	288
9	INFRASTRUKTURE	34	15			9			1	34
10	ANKESA - AKTPERCELLJE	21	6						15	21
	GJITHSEJT	1019	603	11	0	41	26	26	140	1019

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Raportimi dhe vlerësimi i projekteve në proces, ato në përfundim, dhe të tjerat në vazhdimësi në kuadër të përfundimit të vitit 2020 pranë DSHMS-së.

- Gjatë muajve Shkurt – Mars janë zhvilluar vizita në teren. Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe cilësisë së punës, është bërë monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës dhe shërbimeve në 10 pikat e QKMF-së, dhe 15 pikat e AMF-së së Komunës së Gjakovës, si dhe QPS-së.
- Hartimi i specifikacioneve për hapje të kontratave të planifikuara për këtë vit fiskal, si dhe vlerësimi i tyre pranë zyrës së prokurimit për nevoja të Kujdesit Parësor Shëndetësor, si me poshtë:
- Renovimi i objekteve të QKMF-së, QMF-ve si dhe AMF-ve nëpër fshatra.
- Furnizim me barna emergjente
- Furnizim me material shpenzues dhe pajisje stomatologjike
- Furnizim me aparatura mjekësore dhe jo mjekësore
- Pajisje dhe furnizim me aparaturë pune për laborator stomatologjik.
- Automjet për vizita për njësinë e vaksinimit
- Furnizimi me pajisje të Eho-kardiogafit- statik
- Furnizim me pajisje mjekësore- oksigjenator për nevoja të QKMF-së.
- Pajisje dhe furnizim me kompjuter për KPSH dhe Qendrën për Pune Sociale .
- Ndërtimi i ashensorit për QKMF ekzistuese.
- Shërbimi për mirëmbajtje dhe pastrim të objekteve të KPSH dhe QPS- së.
- Mirëmbajtja e aparaturave stomatologjike, mjekësore dhe të laboratorit.
- Tenderi i furnizimeve mjekësore të materialit për laborator hematologjik- biokimik.
- Ndërtimi i ashensorit dhe kafazit të ashensorit- Në proces
- Blerja e aparatit me rrymë të oksigjenit – Në proces

- Me kërkesën e DSHMS-së drejtuar KRU-Gjakova, këtë vit është paraparë kyçja e tyre në rrjetin e kanalizimit dhe të ujësjellësit për 8 Ambulanca të Mjekësisë Familjare nëpër fshatra. Gjatë kësaj kohe të raportimit është kryer kyçja e 6 ambulancave në rrjetin e KRU Gjakova.
- Të hyrat e planifikuara për vitin 2020 kanë qenë 70,000.00 euro. Nga kategoria e mallra dhe shërbimeve 60,000.00 si dhe 10,000.00 euro nga kategoria e pagave. Deri në këtë periudhë gjithsejtë të hyra janë 66.220 Euro.
- Po ashtu gjatë periudhës 12 mujore janë kryer dy Thirrje Publike.
- Thirrja e parë publike për subvencione apo ndihmë shtesë në lëmin e shëndetësisë. Është bërë përpilimi i formularëve, shqyrtimi i të gjitha kërkesave të qytetarëve, të cilët kanë aplikuar për ndihma në lëmin e shëndetësisë dhe është hartuar regjistri i ri me emrat e përfituesve të subvencioneve të DSHMS-së.
- Në muajin shtator nga data 07.09.2020-18.09.2020 është bërë Thirrja e dytë Publike apo ndihma në lëmin e shëndetësisë sipas Rregullores së re e cila është miratuar këtë vit.
- DSHMS që nga periudha e 16 marsit ku është shpallur Pandemia Covid-19 e kryen edhe shërbimin e Shtabit Emergjent. Deri më tani kemi pasur 270 shërbime të ndryshme për qarkullim të cilat iu janë ofruar qytetarëve.
- Çdo ditë ofrimi i informatave dhe shërbimeve për të gjitha palët ndaj kërkesave të tyre.

Drejtoria për Punë Inspektuese

Planifikimi dhe realizimi			
Nr.	Përshkrimi	Planifikimi për periudhën Janar-Dhjetor	Realizimi për periudhën Janar-Dhjetor
1	Të hyrat nga gjobat e Inspektoratit	17.000 Euro	26,046.74 Euro
2	Të hyrat nga pëlqimet mbi kushtet higjieno -teknike sanitare	39000 Euro	50, 782.21 Euro
3	Të hyrat nga taksa për shërbim me pije alkoolike	24000 Euro	4250 Euro
4	Të hyrat nga inspektimi/vulosja e gjedheve	0 Euro	3000 Euro
5	TOTALI	80000 Euro	84,078.95 Euro
6	Të hyrat nga gjobat shqiptuara nga Gjykata	////	18350 Euro
7	GJITHSEJ TË HYRA	80000 Euro	102,428.95 Euro

Inspektimet			
Nr.	Përshkrimi	Planifikimi për periudhën Janar-Dhjetor 2020	Realizimi për periudhën Janar-Dhjetor 2020
1	Inspektime	3590	5442

Statistikat e përgjithshme të punës për periudhën janar-nëntor 2020

Përshkrimi	Inspektorati i Tregut	Inspektorati Sanitar	Inspektorati i Veterinarisë	Inspektorati i Bujqësisë	Inspektorati i Sh. Publike	Inspektorati Mjedisit	Inspektorati Ndërtimit	TOTALI
Inspektime të kryera	610	843	719	164	2500	229	377	5442
Urdhëresa për eliminim të parregullsive	304	410	36	58	400	50	7	1265
Gjopa të shqiptuara	56	47	0	0	126	13	9	251
Lëndë të pranuar	339	809	17	40	182	40	108	1513
Kallzime penale	/	/	/	/	/	0	0	0
Produkte të asgjësuar	242 Kg	548 kg 6076 L	637 kg	0	0	0	/	1427 Kg 6076 L
Produkte të sekuestruara	2542L	/	/	/	/	/	/	2542 L
Mostra të marra	/	1	/	1	/	/	/	2
Propozime për Përmbardim	11	12	0	0	31	5	7	67
Kërkesa për fillim të procedurës për Kundërvajtje	25	766	14	25	36	/	/	841
Gjopa të shqiptuara nga Gjykata	0	7	5	19	0	2	14	44
Ndalime të përkohshme të veprimtarisë	19	0	0	0	0	0	9	28

Pëlqime mbi plotësimin e kushteve minimale teknike e sanitare	150	/	/	/	/	/	/	150
Certifikata për shërbim me pije alkoolike	/	/	/	29	/	/	/	29
Pëlqime Sanitare të lëshuara	/	36	/	/	/	/	/	36
Vendime për izolim		2078						2078
Monitorim i varrimeve	/	83	/	/	/	/	/	83

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Për arsye të situatës nga pandemia, DKRS nuk ka arritur të realizoi tërësisht Planin e Punës të planifikuar për vitin 2020. Gjatë gjithë kohës është dhënë maksimumi duke shfrytëzuar rregullat ekzistuese në parandalimin e përhapjes së pandemisë në mënyrë që kalendari i aktiviteteve Kulturore, Rinore dhe Sportive të jetë aktiv.

Sektori i Kulturës

Aktivitete të përgjithshme gjithsej: 82

Shfaqje Teatrale Profesionale, Ekspozitë Personale / Kolektive – Prezantim Online dhe Orë Letrare (Mitingu i Poezisë '56) - Prezantim Online.

Përfshirë edhe Aktivitetet të cilat janë organizuar në fushën individuale të prezantimit online në kuadër të promovimit kulturo - artistik.

Sektori i Rinisë

Aktivitete të përgjithshme gjithsej: 13

Prezantim Online, Promovim Online.

Përfshirë edhe Aktivitetet të cilat janë organizuar në fushën individuale të prezantimit online në kuadër të promovimit të iniciativës vetdijësuese nga sektori i Rinisë.

Sektori i Sportit

Aktivitete të përgjithshme gjithsej: 270

Ndeshje Zyrtare, Orë Sportive Prezantim Online, Garat në kuadër të Federatave dhe ushtrime sportive.

Përfshirë edhe Aktivitetet të cilat janë organizuar në fushën individuale të prezantimit online në kuadër të pjesëmarrjes për prezantimin e veprimtarisë sportive.

• **Investimet Kapitale:** të parapara sipas planit të DKRS-së, janë përfunduar të gjitha Plan Projektet dhe Paramasat e Paralogaritë si: Furnizim 4 pozicione – 4 pozicione janë përfunduar, Kontrat për Shërbime 4 pozicione – 4 janë përfunduar dhe Investime Kapitale 5 pozicione.

• **Subvencionet:** në fushën e Kulturës dhe të Sportit, ka përfunduar procesi i Thirrjes Publike, ku kanë aplikuar 49 OJQ të Kulturës dhe Klube Sportive, nga të cilat 10 OJQ të Kulturës dhe 33 Klube Sportive janë përfituese nga skema e subvencioneve, procesi i të cilave vazhdon gjatë gjithë vitit për përmbylljen e projekteve për implementim. Procesi i Thirrjes Publike në fushën e Rinisë, ku kanë aplikuar 3 OJQ Rinore, 3 prej tyre janë përfituese nga skema e subvencioneve në përputhje me Thirrjen Publike.

• **Bashkëpunimet:** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, CHWB, Ambasadat e huaja, Tropa e Baletit Kombëtar, Muzeu Kombëtar, etj mbi organizimin e eventeve të ndryshme në Komunën e Gjakovës.

• **Të tjera:** Me lehtësimin e masave anti Covid nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës, DKRS në tre mujorin e fundvitit është angazhuar që të realizoi në përpikmëri planin e punës për vitin 2020, me eventet e parapara tradicionale si: “Lyra Fest 2020”, Premiera nga Teatri i Qytetit, Organizimi Kulturo Artistik “N’oden e Malësisë së Gjakovës”, organizimi i festave të fund vitit – prezantimi online i koncertit të fund vitit nga “Ansambli i Komunës së Gjakovës”, promovimi i këngëve dhe valleve nga Ansambli Kulturo Artistik “Gjakova” dhe shumë aktivitete të tjera Kulturore, Rinore dhe Sportive.

SUBVENCIONET PËR OJQ - të Rinore në kuadër të sektorit të Rinisë / 2020

1	OJQ Këshilli i Veprimit Rinor Lokal / KVRL	2,500.00 euro
2	OJQ EDGE	1,000.00 euro
3	OJQ GWYA	1,500.00 euro

SUBVENCIONET PËR OJQ-të NË FUSHËN E KULTURËS / 2020

Aplikimet në Thirrje Publike		
1	OJQ – Neo Muzika / Lyra Fest	3,000.00 euro
2	OJQ – Ashikët	1,000.00 euro
3	Klubi Letrar “Gjon Nikollë Kazazi” Mitingu i Poezië	3,000.00 euro
4	OJQ – RAGJ	4,000.00 euro
5	OJQ - Ardhmëria	2,500.00 euro
6	OJQ – Pro Cult	500.00 euro
7	Ansambli Kulturo Artistik “Isa Boletini”	1,500.00 euro
8	Shoqata e Intelektualëve “Jakova”	500.00 euro
9	OJQ – DU ART	2,500.00 euro
10	OJQ – Ansambli i Këngëve Popullore	3,500.00 euro

SUBVENCIONET PËR KLUBET DHE OJQ-të SPORTIVE PËR VITIN / 2020

Klubet Sportive		Viti 2020
1	KF – Vëllaznimi	5,000.00 euro
2	Klubi i Futbollit “Dushkaja”	2,000.00 euro
3	Klubi i Futbollit “Rilindja e Kosovës”	2,000.00 euro
4	Klubi i Futbollit “Dukagjini”	2,000.00 euro
5	Klubi i Futsallit “Liburn”	6,000.00 euro
6	Klubi i Hendbollit “Vëllaznimi” Meshkujt	6,000.00 euro
7	Klubi i Hendbollit “Shqiponja” Femrat	4,000.00 euro

8	Klubi i Basketbollit “Vëllaznimi” Meshkujt	10,000.00 euro
9	Klubi i Basketbollit “Vëllaznimi” Femrat	4,000.00 euro
10	Klubi i Futbollit “United Boys Gjakova”	1,500.00 euro
11	Klubi i Boksit dhe Karatesë “Sport Center”	2,000.00 euro
12	Klubi i Karatesë “Dukagjini”	500.00 euro
13	Klubi i Çiklistëve “Gjakova 137”	2,000.00 euro
14	Klubi i Pingpongut “Vëllaznimi”	1,000.00 euro
15	Klubi i Shahut “Vëllaznimi”	1,500.00 euro
16	Klubi i Tenisit “Sporek”	1,000.00 euro
17	Klubi i Mua Thai “Gjakova”	500.00 euro
18	Klubi i Volejbollit “Vëllaznimi” Meshkujt	3,000.00 euro
19	Klubi i Peshkatarëve “Ereniku”	500.00 euro
20	Klubi i Peshkatarëve “Radoniqi”	500.00 euro
21	Klubi i Futbollit “Korenica”	1,500.00 euro
22	Klubi i Atletikës “Vëllaznimi”	300.00 euro
23	Garat e Urës së Fshejtë / Kërcyesit e Urës	2,500.00 euro
25	Klubi i Peshkimit “Qingji i Ujit”	500.00 euro
26	Klubi i Futbollit “Dardanët”	2,000.00 euro
27	Klubi i Futsallit “Letaj”	2,000.00 euro
28	Klubi i Volejbollit “Vëllaznimi” Femrat	2,500.00 euro
29	Klubi i Tenisit “Hot Shot”	1,000.00 euro
30	Klubi i Futbollit “Gjakova”	2,500.00 euro
31	Klubi i Futbollit “Vjeshta”	1,500.00 euro
32	Klubi i Tenisit “Gjakova”	1,000.00 euro
33	Klubi i Basketbollit “Gjakova”	1,000.00 euro
34	Shoqata e të Verbërve	1,000.00 euro

PROJEKTE KAPITALE

- **Furnizimi dhe Montimi me paisje LED në Palestrën e Sporteve “Shani Nushi” Gjakovë (faza dytë)**

Projekti: Instalimi i paisjeve të ndriçimit (faza e dytë), sipas standarteve të FIFA-së dhe UEFA-së,

Muaji: Gusht – projekt i kompletuar, **Shuma:** 10,000.00 euro.

- **Furnizimi me Rafta në Bibliotekën Publike “Ibrahim Rugova” Gjakovë (faza e dytë)**

Projekti: Montimi i rafteve për libra në Bibliotekën Publike. **Muaji:** Korrik – projekt i

kompletuar. **Shuma:** 7,000.00 euro.

- **Rivitalizimi i Eshtnores – Çabrat në Gjakovë**

Projekti: Amfiteatër i hapur – rekreativ. **Muaji:** Kontratë 2 vjeqare – në proces, **Shuma e paraparë:** 108,000.00 euro.

- **Renovimi i Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi” në Gjakovë**

Projekti: Galeria e Arteve & Zërimi i Sallës Univesale, **Muaji:** Nëntor, në proces, **Shuma:** 22,000.00 euro.

- **Renovimi / Rrethimi i Tereneve Sportive**

Projekti: Përmirësimi i Infrastrukturës Sportive, **Muaji:** Kontratë 2 vjeqare, në proces, **Shuma:** 11,000.00 euro.

Drejtoria për Arsim

Numri i të punësuarve në institucionet e arsimit në Gjakovë

Për vitin shkollor 2020 - 2021 në shkollat e komunës janë:

- Mësimdhënës 1225
- Administratë 78
- Personel ndihmës 211

Gjithsej: 1514 persona

Raporti i numrit të nxënësve për vitet shkollore 2020/2021

- Numri i fëmijëve në kopshte: 458
- Nr. i fëmijëve parashkollor në shkolla: 890
- Nr. i nxënësve prej klasës së I – IX: 11022
- Nr. i nxënësve prej klasës së X–XII: 3858

Gjithsej: 16.228 fëmijë dhe nxënës

Rekrutimi i punëtorëve të rinj 2019/2020

- Gjatë vitit 2019/2020 (Janar-Qershor/2020) – janë shpallur 2 konkurse në të cilët janë punësuar 12 veta.

Investimet në objektet shkollore 2019/2020 sipas kontratës:

Emri i shkolles	VENDI	INVESTIMET (€)
"Emin.Duraku"	Gjakovë	8,926.18
"Mustafa Bakija"	Gjakovë	9,143.54

"Yll Morina"	Gjakovë	7,197.17
"Mazllum Këpuska"	Gjakovë	29,999.66
"Zekeria Rexha"	Gjakovë	20,335.78
"Selman Riza"	Gjakovë	7,722.43
"Zef Lush Marku"	Brekoc	15,712.84
"Anton Çetta"	Dol	3,238.16
"Ganimete Tërbeshi"	Ponoshec	1,110.00
"Dy Dëshmorët"	Sheremet	6,813.63
"Gjergj Fishta"	Bishtazhin	185.00
"Haxhi Hoti"	Rogovë	1,760.90
"Durak Ahmeti"	Demjan 1	7,887.13
"Pjetër Bogdani"	Demjan 2	925.00
"Malush Stavileci"	Goden	1,104.56
"Fan Noli"	Dujakë	439.10
"Engjëll Gjoni"	N. e Ulët	16,760.56
"Ahmet Rrustemi"	Bec	4,716.03
"Ahmet Rrustemi"	Zhdrellë	3,758.14
"Dëshmorët Dushkajës"	Bardhaniq	1,665.00
"Dëshmorët e Kombit"	Shqiponjë	4,826.00
Gjimnazi "Hajdar Dushi"	Bishtazhin	740.00
Gjimnazi Rogovë	Rogovë	1,852.33
"Hysni Zajmi"	Gjakovë	8,966.40
"Kadri Kusari"	Gjakovë	579.59
Çerdhja "G.Tërbeshi"	Gjakovë	12,856.20
Konvikti "S.Stavileci"	Gjakovë	9,659.76
TOTALI		188,881.09

Kontrata është realizuar tërësisht.

- **Ndërtimi i depos në shk. “Jahë Salihu” Molliq**

Vlera e kontratës 8.816,73 €

Kontrata është realizuar në tërësi

- **“Instalime dhe renovime të ngrohjeve qendrore”**

Janë kryer instalimet e ngrohjes qendrore në shkollat:

1. SHF “Zenel Sadiku” Babaj Bokës
2. SHF “Dëshmorët Lleshi” Doblibare
3. SHF “Dëshmorët e Hereqit” Hereq

Vlera e kontratës: 63.723,55 euro

- **“Instalimi dhe rregullimi i ngrohjes qendrore në shkolla”**

Pasi tenderi i parë ka qenë më i lirë se planifikimi i drejtorisë është shpallur edhe një tender për shkollat:

1. SHF “ 8 Dëshmorët ” Bardhaniq, është kryer instalimi komplet i ngrohjes qendrore
2. SHF “Dëshmorët e Dushkajës” Bardhaniq, renovimi i ngrohjes qendrore dhe kthimi i kaldajës nga lënda djegëse naftë në Pelet.

Vlera e kontratës: 19.989,66 euro

- **Rrethime dhe rregullime të oborreve**

Janë planifikuar punime në rrethime dhe rregullime në këto shkollat:

1. SHF “ “Gjergj Fishta” Bishtazhin
2. SHF “Mazllum Këpuska” Gjakovë
3. Shkollën “8 Dëshmorët” Kralan
4. SHF “Zenel Sadiku” Babaj Bokës
5. SHMM “Hysni Zajmi” Gjakovë
6. Çerdhe “G. Tërbeshi”
7. SHK “Ardhmëria” Ramoc
8. SHF “ Zef Lush Marku” Brekoc
9. SHF “Luigj Gurakuqi” Korenicë

Janë bërë punime në rrethime dhe rregullime të oborreve në vlerë rreth 5.000 euro në shkollat SHF “Luigj Gurakuqi” Korenicë dhe Çerdhe “G. Tërbeshi” Lokali Orize (është punuar staza për hyrje në shkollë)

Kontrata është ndërprerë nga ana e OE

Është shpallur një tender i dytë por nuk është nënshkruar ende kontrata.

- **“Ndërtimi i terreneve sportive”**

Për vitin 2020 janë planifikuar punimi i terreneve sportive në këto shkolla:

1. SHF “Zekeria Rexha” Gjakovë
2. SHF “Luigj Gurakuqi” Korenicë dhe
3. SHF “7 Shtatori” Gërqinë

Vlera e kontratës : 62.094,60 euro

Punimet janë në përfundim.

- **“Molerimi i shkollave”**

Janë planifikuar 15.000 m² molerim i shkollave dhe 3650 m² suvatime në shkollën “H. Hoti” Rogovë.

Punimet janë kryer në shkollat:

1. SHFMU “Haxhi Hoti” Rogovë
2. SHF “Mustafa Bakija” Gjakovë
3. SHFMU “Shaban Golaj” Lipovec
4. SHFMU “Pjetër Bogdani” Demjan 2
5. SHFMU “Zef Lush Marku” Brekoc
6. SHFMU “Haxhi Hoti” Rogovë
7. SHFMU “Sylejman Vokshi” Smolicë
8. SHFMU “Yll Morina” Gjakovë

Vlera e kontratës : 17.800,00 euro.

Punimet kanë përfunduar.

- **Renovimi i kulmit në Shk “Haxhi Hoti” Rogovë**

Vlera e kontratës 42.071,54 €

Punimet kanë përfunduar.

Për vitin 2020 kanë qenë të planifikuar 70.000,00 euro për renovimin e kulmit në shkollën në Rogovë, meqë nga tenderi na kanë mbetur mjete e kemi shpallur edhe një tender për renovimin e kulmit në shkollën “Sh. Golaj” në Lipovec.

- **Renovimi i kulmit në Shk “Shaban Golaj” Lipovec**

Vlera e kontratës 16.970,20 €

Punimet janë në përfundim

- **Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shk “Kadri Kusari” Gjakovë**

Vlera e kontratës 199.999,00 €

Punimet kanë filluar më datë 31.08.2020 dhe do të vazhdojnë edhe në vitin 2021.

Deri tani janë realizuar punime në vlerë prej 50.000,00 euro

- **Ndërtimi i çerdheve në Gjakovë**

Janë planifikuar të kryhen punimet në:

- Ndërtimin e aneksit të çerdhes në Lokacionin Orize
- Renovimi i objektit në fshatin Novosellë e Ulët
- Renovimi i objektit në Çabrat

Vlera e kontratës 150.311,70 €

Punimet kanë filluar më datë 05.10.2020 në Orize dhe Novosellë të Ulët dhe do të vazhdojnë edhe në vitin 2021.

Deri tani janë realizuar punime në vlerë prej 27,131.96 euro

Investimet nga Donatorët:

1. Ndërtimi i sallës së Ed. Fizike në shk. “H. Hoti” Rogovë

- Donatorë MASHT
- Vlera e ndërtimit 297,184.84 euro
- Janë duke vazhduar punimet

2. Ndërtimi i shkollës në Korenicë

- Donatorë MAPL
- Vlera e ndërtimit 297,184.84 euro
- Janë duke vazhduar punimet

• Kontrata “Renovimi i nyjeve sanitare”

Kontratë kornizë 2019/2020/2021 e nënshkruar me datë 22.10.2019, në vlerë prej 149,811.00 euro.

Në vitin 2020 janë realizuar punime dhe renovime të nyjeve sanitare në vlerë 70,000.00 euro në shkollat:

1. SHFMU “Ganimete Tërbeshti” Ponoshec
2. SHFMU “Yll Morina” Gjakovë
3. SHFMU “Zekeria Rexha” Gjakovë
4. SHFMU “Ahmet Rustemi” Bec dhe Zhdrellë
5. SHFMU “Anton Çetta” Dol
6. SHFMU “Dëshmorët e Dushkajës” Bardhaniq
7. SHFMU “Mustafa Bakija” Gjakovë
8. ÇERDHE - Lokali Orize dhe Devë
9. Gjinnazi Cërmjan
10. SHFMU “Dëshmorët e Kombit” Shqiponjë
11. SHFMU “Mazllum Këpuska” Gjakovë
12. SHFMU “Pjetër Muqaj” Guskë
13. SHFMU “8 Dëshmorët” Kralan

Ndërsa punimet sipas kontratës do të vazhdojnë në vitin 2021, ku mbesin për realizim edhe 72,473.84 euro.

- **Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore**

Vlera e kontratës 171,900.40 euro

Kontraktori: N.N.Sh. “Korben” Gjakovë

Gjatë vitit 2020 janë realizuar punime në shkolla në vlerë prej 95,465.44 euro, gjegjësisht janë punuar:

- Dysheme 4010,78 m² me pllaka graniti
- Dritare në çerdhen “Ganimete Tërbeshi” Gjakovë
- Dyer në shkolla 28 copë
- Suvatime dhe molerime 26.000 m²
- Përforcime në pllakën e ndërkatit në shkollat “Yll Morina” dhe “M. Bakija” Gjakovë

Projektet e realizuara nga Donatorët në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta dhe të Larta

- Projekti i organizuar nga KEC në bashkëpunim me DA –në për mësimdhënësit e SHFMU “Mbështetja teknike për komunat në zbatimin e planeve të veprimit për ri integrim arsimor dhe gjithë përfshirje sociale të fëmijëve të rikthyer, pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe fëmijëve me nevoja të veçanta” me këto tema: “Ngritja e kapaciteteve të EPRMB-ve” (platforma online),” Orët shtesë të gjuhës për nxënësit e riatdhesuar” (Platforma online) dhe “Plani Individual i Arsimit “(Platforma online) (Prill-Qershor/2020);
- **ALLED 2** – Projekti: “ Harmonizimin i Arsimit dhe Aftësimit me nevojat e tregut të punës” financuar nga BE me bashkëfinancim nga ADC;
- Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Caritas Kosova: “Orientimi në karrierë” .
- EPRBM në nivel komunal me angazhimin maksimal në terren për bindjen e nxënësve që t’iu kthehen bankave shkollore nga minoriteti RAE, për çdo vit mbi 40 nxënës rrezikohen në braktisjen e shkollës. Janë zhvilluar takime me ekipet e EPRBM në nivel shkolle dhe në nivel komunal në çdo 3 muaj apo më shpesh sipas rasteve që paraqiten nga shkollat.
- Donacionet nga OJQ dhe institucionet e ndryshme
- Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini- donacion nga aktori Blerim Destani 50 tableta,

- MASH- 5000 maska për nxënësit prej klasës së parë deri në klasën e gjashtë për raste emergjent,
- MASH nga OSBE 35 tableta për nxënësit e shkollave të komunës së Gjakovës
- GIZ – donacion 4 shkollave kampion 335 tableta
- “Save the Children ka dhuruar 79 tableta, 77 pako edukative dhe 118 pako higjienike për nxënësit me Aftësi të kufizuar dhe për nxënësit me gjendje të rëndë ekonomike;
- Ambasada Japoneze 5 tableta

Aktivitete të ndryshme shkollore

- Gara për vizatimin më të mirë me temën “Çka të bënë të lumtur” organizuar nga Ambasada e Finlandës në Prishtinë
- Në SHFMU “Zekeria Rexha”- Krijimi i Klubeve për Karrierë dhe Shkencë në bashkëpunim me GIZ;
- Organizimi i garave Olimpike për nxënësit e klasëve të 6-ta në platformën online
- Ora Letrare në nivel të komunal për nder të “7 Marsit”
- Zhvillimi i mësimi joformal në SHML “Nexhmendin Nixha” në profile të ndryshme për klasat X-XII mosha mbi 18 vjeç
- Zhvillimi mësimi joformal në SHFMU “Emin Duraku” përfitues nxënësit e moshës mbi 15 vjeç të cilët kanë ndërprerë shkollimin e tyre të rregullt
- Koordinimi i aktiviteteve të shkollave me “BONEVET”

Subvencione

- Shpërndarja e 50 bursave në nivel Komunal për studentët të cilët studiojnë në Universitetet Publike të Kosovë për vitin akademik 2019/2020.
- Pagesa e transportit të nxënësve me nevoja të veçanta që udhëtojnë në relacione të ndryshme.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Realizimi i mbjelljeve pranverore

Kulturat	Planifikimi (ha)	Realizimi (ha)	%
MISËR	4.100 ha	4.100 ha	100%
ELB	120 ha	120 ha	100%
TËRSHËR	140 ha	140 ha	100%
BIMË FURAGJERE	160 ha	160 ha	100%
PATATE	140 ha	140 ha	100%
FASULE MONOKULTURË	12 ha	12 ha	100%
PERIME	950 ha	950 ha	100%
Kultura tjera	10 ha	10 ha	100%
Gjithsej	5.632ha	5.632 ha	100%

- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural gjatë vitit 2020, ka pranuar gjithsej **385** kërkesa të ndryshme të cilat janë drejtuar nga palët e interesuara për çështje të caktuara.
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural gjatë kësaj periudhe ka miratuar rreth **37** pëlqime për shndërrimin e tokës bujqësore në jo bujqësore.

- Duke marrë parasysh kohën e pandemisë dhe karantinën në të cilën u nënshtroam gjatë 6 muajve të parë të vitit, drejtoria ka regjistruar dhe pajisur rreth 400 fermerë me NIF dhe Aneks për qarkullim të lirë pa orar.
- Në kuadër të thirrjes për Aplikim për Cilësi Qumështi nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në afatin kohor prej 15.01.2020-15.02.2020 kanë aplikuar **87** fermerë.
- Në kuadër të thirrjes për aplikim të subvencioneve gjegjësisht për Pagesa Direkte nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në afatin kohor prej 20.07 - 28.08.2020 kanë aplikuar **1089** fermerë.

Korrje Shirjet – 2020

Kultura	Sipërfaqet e planifikuara për korrje	Realizimi	Përqindja
Gruri	4500 ha	4500 ha	100 %
Thekna	140 ha	140 ha	100 %
Trokal	20 ha	20 ha	100 %
Total	4.660 ha	4.660 ha	100 %

Sektori i Pylltarisë

Sektori i Pylltarisë gjatë periudhës një vjeçare ka pranuar 26 kërkesa për lëshim leje për prerjen e pyjeve private nga të cilat 20 janë aprovuar me masë drunore 625.60m³ dru zjarri ndërsa nga prerjet ilegale janë konfiskuar 126.88 m³ dru zjarri.

Masa drunore e konfiskuar është shitur përmes Tenderit/Ankandit publik në vlerë prej 3,336.94 euro. Angazhime në shuarjen e zjarrit 12 raste.

Fletëparaqitjet në Gjykatën Themelore të Gjakovës.

Kundërvajtje	129 me vëllim 221.75m ³ .
Penale	21 me vëllim 90.40m ³
Gjithsej	150 me vëllim 312.15

Subvencione

- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Gjakovës gjatë vitit 2020 ka subvencionuar **75 fermerë** me Serra të kapacitetit 240m², 150m² dhe 50m² . Vlera e projektit në total është **68,500.00 euro**
- Gjithashtu janë subvencionuar **38 fermerë** me Moto-kultivatorë dhe Freze. Vlera e projektit është **24,624.00 euro**.
- Drejtoria është në përfundim të procedurave për subvencionimin e **52 bletarëve** me pajisje për Bletari. Vlera e projektit është **13,000.00 euro**.

Investime Kapitale

Ndërtimi i Kanaleve të ujitjes

Kompania e kontraktuar nga Komuna e Gjakovës për ndërtimin e kanaleve të ujitjes ka ndërtuar Kanale të ujitjes për nevoja të komunitetit për ujitje të tokave bujqësore.

- Skivjan 800 metra
- Dobrigje 800 metra

- Novosellë e Epërme 400 metra
- Ponoshec 676 metra
- Smolicë 1653 metra
- Shishman 110 metra
- Duzhnje dhe Zhdrell.

Vlera e projektit për këto investime është 4916 metra = **196,648.38 euro.**

Gjithashtu në kuadër të sanimit të kanaleve të ujitjes janë riparuar kanale në fshatin Rakovinë, në vlerë prej **16,402.00 euro.**

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

- Hartimi i Kornizës afatmesme buxhetore 2021-2023
- Hartimi i Planifikimit tenderues për vitin 2021
- Hartimi i Planit të rrjedhjes së parasë për vitin 2020

Mjete të planifikuara për 2020:

- Mallra dhe Shpenzime 70,000.00 € (shpenzueshmëria 100 %)
- Shpenzime komunale 18,000.00 € (shpenzueshmëria rreth 60 %)
- Investime kapitale 0.00 €
- Subvencione..... 0.00 €

Borxhe të mbetura për vitin 2021 1,388.60 €

OENDRA OPERATIVE-112

Deri në momentin e përpilimit të këtij Raporti në Qendrën e thirrjeve-112 janë pranuar gjithsej **25.563** thirrje dhe janë menaxhuar **458** raste me strukturat reaguese dhe shërbyese si: Zjarrfikësit, Policinë e Kosovës, FSK, KFOR, Kryqin e Kuq, KRU Gjakova, KEDS, KRM “Çabrat”, OJQ,etj

STUHITË- Menaxhimi i situatës së shkaktuar nga stuhitë gjatë shkurtit/2020

Struktura e dëmeve ka qenë kryesisht në objekte të improvizuara dhe në kundërshtim me normat tekniko- ndërtimore, pastaj stalla të lopëve, shupa, drunjë në qytet, shtylla elektrike etj., derisa në bujqësi jemi ballafaquar me dëmtimin e serave, kryesisht të mbulesave prej najloni. Në secilin rast Drejtoria ka qenë në vendngjarje, ka bërë konstatimin e dëmit dhe në disa raste ka përcaktuar edhe vlerën e përafërt të dëmit.

Vërshimet - Menaxhimi i situatës së shkaktuar nga vërshimet – tetor 2020

Gjatë këtij viti, territori i Komunës së Gjakovës nuk është ballafaquar me fenomenin e vërshimeve si fatkeqësi natyrore si pasojë e daljes së lumenjëve nga shtrati tyre. Më tepër jemi ballafaquar me vërshime urbane si pasojë e bllokimit të rrjetit të kanalizimit dhe atij atmosferik. Përmes Njesisë Zjarrfikëse, qytetarëve iu është dalë ndihmë në thithjen e ujit nga bodrumet dhe përdhesat e shtëpive, në lagjen Hadum, Dardani, Haxhi Ymer dhe Blloku i Ri.

Zjarret - Menaxhimi i situatës nga zjarret

Territori i komunës së Gjakovës pothuajse 2-3 herë në vit kërcënohet në masë të madhe nga zjarret pyjore dhe fushore të cilat janë të shkaktuara nga faktori njeri. Periudhat më kritike të zjarreve masive është Shkurt/Mars kur fermerët bëjnë përgatitjen e tokës për mbjelljet pranverore dhe djegia e hamullishteve të cilat dalin jashtë kontrollit, si dhe gjatë periudhës Korrik-Shtator.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Brigada e Zjarrfikësve ka intervenuar gjithsejtë në 558 raste prej të cilave pjesa dërrmuese janë zjarre pyjore-fushore 342, ndërsa 216 raste janë zjarre në amvisëri dhe subjekte afariste.

Po ashtu njësia e mbrojtjes nga zjarri ka qenë në mënyrë sistematike e angazhuar në shuarjen e zjarrit në stacionin transfer “Ali Ibra” në Koloni, në koordinim me dikasteret tjera komunale dhe KRM “Çabrat” Përndryshe, krahasuar me vitin 2019, ky vit ka qenë më i qetë sa i përket angazhimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe me dëme ekonomike më të vogla.

Koordinimi me FSK - Rreziqet nga mjetet mino-eksplozive

Gjatë vitit 2020-të drejtoria ka pranuar vetëm 1 kërkesë për ekzaminim terreni nga mjetet e pashpërthyer mino-eksplozive (Brekoc i Ulët), rast ky i cili është koordinuar me Qendrën e Situatave të Forcës së Sigurisë.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me Njësinë e specializuar të FSK-së për Deminim (EOD) në identifikimin dhe pastrimin e zonave të minuara, sidomos rreth brezit kufitar në segmentin që shtrihet mbi fshatin Babaj Bokës si dhe në bazë të kërkesave individuale të qytetarëve.

Njëkohësisht, gjatë këtij viti janë mbajtur dy takime me Komandën e Batalionit të Reagimit të Shpejtë me seli në Istog (Njësi që mbulon edhe territorin e komunës së Gjakovës në rast të emergjencave të nivelit 3 dhe 4, që nënkupton shkallën kritike dhe katastrofale), gjithnjë me qëllim të koordinimit të planeve mbrojtëse për reagim në situata eventuale emergjente.

INTERVENIME EMERGJENTE

Në kuadër të programit të masave preventive për parandalimin e vërshimeve dhe zvogëlimin e pasojave nga to, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar gjithsejtë 5 intervenime në pikat më të ndjeshme në komunë. Numri i këtyre intervenimeve emergjente gjatë këtij viti krahasuar me vitin 2019 dukshëm më i vogël për shkak të gjendjes relativisht stabile të pikave kritike për vërshime.

Përmes operatorit ekonomik, gjatë muajit tetor/nëntor 2020 është intervenuar në pikat më kritike për parandalimin e vërshimeve përgjatë lumit “Krena” dhe “Llukac”, në:

LOGJISTIKA

- Mirëmbajtja dhe furnizimi i vazhdueshëm i automjeteve zjarrfikëse;
- Realizimi i procedurave për regjistrimin e automjeteve të Shërbimit Zjarrfikës;
- Ndriçimi i hapësirave të jashtme dhe të autoparkut në Njësinë Zjarrfikëse dhe mirëmbajtjes së objektit
- Furnizimi me mjete dhe paisje për shuarjen e zjarrit me procedurë prokurimi në vlerën prej 20,000.00 €

RAPORTI SITUATËS EMERGJENTE TË SHKAKTUAR NGA RESHJET E SHIUT NË TERITORIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS TË DATËS 30 dhe 31-12.2020

Si pasojë e reshjeve të dendura të shiut të datës 30 dhe 31 dhjetor 2020 nga ora 16:30 Qendra e Thirrjeve-112 është ballafaquar me thirrje të shumta për ndihmë për parandalimin e pasojave nga vërshimet.

Pas konstatimit se gjendja emergjente është duke u përkeqësuar si pasojë e rritjes së nivelit të ujit në kuotat kritike në lumin “Erenik”, “Krena” dhe “Llukac” si dhe përrocka dhe kanalet e ujit, kemi bërë mobilizimin:

- Personeli i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit me kapacitet të plotë
- Operatori ekonomik për intervenime emergjente
- Janë vënë kontaktet fillestare me strukturat komunale, e veçanërisht me drejtorinë për Shërbime Publike, si dhe
- Janë vënë kontakte të drejtëpërdrejta me Stacionin Policor në Gjakovë, KEDS si dhe KRU “Gjakova”

KRONOLOGJIA E RASTEVE 30 dhe 31. 12.2020

1. Përmbytje e bodrumit në rrugën “Tahir Efendija” nr. 35, lagja Hadum, pronë e familjes Zajmi

Shkaku: bllokimi i kanalizimit në rrugën kryesore

Intervenimi: Brigada e Zjarrfikësve me pompa thithëse

2. Përmbytja e plantacionit në fshatin Hereq

Shkaku: kapaciteti i ulët i tubacioneve për qarkullimin e ujit në rrugën e asfaltuar Hereq-Junik

Intervenimi: rasti në fjalë nuk mundëson intervenim emergjent, problemi është i natyrës infrastrukturore

3. **Fshati Botush,**

Shkaku: Dalja e ujit nga shtrati i përrockës Çelija, vërshimi i rrugës së asfaltuar dhe derdhja e ujit në përrockën Gusha. Nuk ka pasur familje të rrezikuara, as depërtim të ujit në prona familjare dhe as dëme esenciale.

Intervenimi: Koordinimi me Stacionin policor dhe ndalim-qarkullimi në rrugën “Hasan Salihu”- minimum 12 orë. Pa pasoja në prona familjare por vetëm vërshim i rrugës.

4. **Fshati Rracaj**

Shkaku: Përmbytja e krahut të majtë të rrugës kryesore të fshatit nga lapidari në Qendër të fshatit deri në dalje të tij- drejtimi i Mejës. Këtu ka pasur dëme relativisht të mëdha në 5-6 shtëpi në këtë krah të rrugës ku më së tepërmi ka pësuar familja e Qëndrim Nurajt dhe Gazmend Beqajt.

Intervenimi: Problemi qëndron në tubacionet skaj rrugës të cilët nuk kanë mundur të përballojnë tërë sasinë e ujit, me ç'rast kërkohet një zgjidhje afatgjate në kuptimin infrastrukturor.

Ndalim-qarkullimi i këtij segmenti rrugor min-12 orë (Emergjenca-Policia)

5. Brekoc i Ulët, rruga “Shote Galica” në afërsi të ish seperacionit të SH.A. “Dukagjini”

Shkak: nga rritja e nivelit të ujit në lumin “Erenik” ka ardhur deri tek vërshimi i rreth 25-30 shtëpi të komunitetit RAE.

Intervenimi: Ekipet e Zhytësve të Njësisë Zjarrfikëse me barkë shpëtimi dhe Policisë kanë arritur të evakujnë 40 persona të rrezikuar për jetë. Evakuimi është bërë në mesnatë, në kushte jashtëzakonisht të rënda për shkak të thellësisë, errësirës së plotë, për shkak të ndërprerjes së rrymës dhe për shkaqe sigurie në këtë zonë.

6. Fshati Gërquinë

Intervenimi: evakuimi i dy familjeve të ngjuara nga uji në lagjen Gjuraj të këtij fshati. Evakuimi i cili është realizuar nga Njësi Zjarrfikës në mesnatën 30/31 dhjetor/2020.

7. Rruga “Shokët e Lirisë”- Gjakovë

Pasoja: depërtimi fillestar i ujit në oborret e disa shtëpive në afërsi të klinikës “Fati Im” si pasojë e daljes së lumit “Krena” nga shtrati i saj.

Intervenimi: Në vendngjarje: Ekipi Zjarrfikës dhe zyrtarëve Policorë në gadishmëri për mbrojtjen e jetës së banorëve.

8. Rruga “ Ahmet Korenica-Skender Shehu” – prapa SH.A. “JATEX”- Gjakovë

Pasoja: Përmbytja e 3 shtëpive si pasojë e daljes ekstreme të ujit nga shtrati i lumit “Krena”. Lumi ka kaluar edhe nivelin e urës pothuajse 1 m lartësi.

Intervenimi:

- si masë sigurie është bërë ndalim-qarkullimi i këtij segmenti rrugor në pikën kritike të ura. Ekzekutues: Emergjenca dhe Policia.

- Të nesërmen, në orët e hershme të mëngjesit, me rënjen e nivelit të ujit, përmes operatorit ekonomik për intervenime emergjente është bërë pastrimi nga mbeturinat, inertet dhe gjësendet tjera.

9. Rr. “Fehmi Agani”- afër trafostacionit Gjakova-1

Intervenimi: dëme nga vërshimet në këtë lokacion nuk ka pasur, por për shkaqe preventive është bërë pastrimi i “synit të urës” mbi lumin “Llukac” nga mbeturinat, inertet, drunj e gjësende tjera, me qëllim të parandalimit të rritjes së nivelit të ujit. Punimet janë realizuar nga operatori ekonomik për intervenime emergjente.

11. Rr. “Ymer Pula” – Ura që lidh Bllokun e Ri në drejtim të Moglicë - Shkugëz
12. **Intervenimi:** si pasojë e daljes së lumit “Erenik” nga shtrati i saj, uji ka kaluar nivelin e urës dhe ka përmbytur disa sipërfaqe bujqësore rreth saj.
 - Për shkaqe sigurie, në koordinim me Policinë është bërë ndalim-qarkullimi 12 orësh i automjeteve dhe personave mbi këtë urë.
 - Të nesërmen në mëngjes, përmes operatorit ekonomik është intervenuar në pastrimin e synave të urës nga drunjtë, trarët ndërtimorë, mbeturinat dhe gjësendet tjera. Intervenimi është bërë nga ura, në pamundësi për të depërtuar në shtrat të lumit.
13. Brekoc i Epërm- rr. “Robert Gashi”

Pasoja: dëmtimi i rrugës së asfaltuar, me ç’rast në mungesë të vijave anësore të rrugës ka ardhur deri te depërtimi i ujit në asfalt duke krijuar vakum nën rrugë me rrezik për çarjen e saj. Intervenimi : përmes operatorit ekonomik për intervenime emergjente është bërë hapja e kanaleve kulluese si masë e përkohshme preventive.
14. Fshati Pacaj

Intervenimi: ndalim-qarkullimi i automjeteve në urë në rrugën lokale të fshatit për shkak të “fjetjes” së shputave të urës dhe deformimit të saj. Vënja e shiritit sinjalizues nga zyrtarët e emergjencës për shkaqe sigurie.
14. Segmenti rrugor Sheremet-Nivokaz

Intervenimi: përmes operatorit ekonomik është bërë zhbllokimi i tubacioneve në rrugën lokale që lidh fshatrat Sheremetaj-Nivokaz
15. **Fshati Osek Hylë-**

Intervenimi: intervenimi në largimin e ujit nga segmenti rrugor Qafa e Osekut në brendi të fshatit në drejtim të kopshtit zoologjik. Ekzekutues: operatori ekonomik për intervenime emergjente.
16. Fshati Bishtazhin – te ura e Terzive

Intervenimi: Hapja e grykës për largimin e ujit i cili kishte depërtuar në punëtorinë e z. Ardian Osmani. Ekzekutues: operatori ekonomik për intervenime emergjente
17. Rr. “Pashko Vasa”- përballë Tjegulltores

Pasoja: si pasojë e rritjes së nivelit të lumit “Krena” ka ardhur deri te përmbytja 5-6 shtëpive.

Intervenimi: Në vendin e ngjarjes kanë qenë prezent zyrtarët e emergjencës, ekipet zjarrfikëse, Policia e Kosovës dhe KEDS me qëllim të evakuimit dhe sigurimit të jetës. Intervenime me teknike ndërtimore për parandalim të vërshimeve në raste të tilla nuk planifikohet.

18. Vlerësim i gjendjes sipas kërkesës së qytetarëve:

- a) Riza Shakta – prapa hallës së sporteve në Gjakovë
- b) Xhafer Abrashi – rr. “Urim Rexha – Gjakovë
- c) Edhem Gjedoviç – “Ferid Imami”- Gjakovë
- d) Besim Shllaku – rr.”Tefik Çanga” , Gjakovë
- e) Arton Lurboja - rr. “ Fehmi Agani”

Gjatë kësaj periudhe raportuese, kjo drejtori ka pranuar dhe proceduar gjithsej **78 lëndë**, prej të cilave dy janë refuzuar.